(në nivel kombëtar). Në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Posaçme, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Planet për Zhvillim Urban, Planet Rregulluese Urbane. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 5 vjetëve dhe ta përfshijë një plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Po ashtu duhet ta përfshijë një përmbledhje të shkurtër të ndikimeve shoqëro-ekonomike dhe mjedisore. Raporti i VSM, identifikon që institucioni kryesor që është përgjegjës për zbatimin e ligjit të sipërpërmendur në nivel kombëtar është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) e cila në pajtim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor. MMPH është po ashtu përgjegjëse për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin. Në kuadër të sistemit të Kosovës të planifikimit në dy nivele, niveli i qeverisjes lokale ka rol të rëndësishëm në zbatimin e parimeve dhe të kërkesave planifikuese të përcaktuara nga Ligji për Planifikimin Hapësinor. Komunitetet e Kosovës luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e komuniteteve të tyre, duke krijuar pasuri dhe duke imponuar identitetin lokal. Shoqëria duhet të ketë udhëheqje të fuqishme që i bashkon të gjitha palët e interesuar relevante, përfaqësuesit e komunitetit dhe të biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin e strategjisë duke u bazuar në një vizion të përgjithshëm. Ky është njëri nga aktivitetet kryesore që pritet ta kryejnë komunat.

“Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;

“Për taksën e karbonit e të ambalazhit plastik”;

Krahas hartimit të ligjeve, vitet e fundit, është punuar për plotësimin me akte nënligjore të ligjeve të miratuara, me qëllim që të lehtësohet zbatimi praktik i tyre: Drejtim tjetër të rëndësishëm në plotësimin e kuadrit ligjor, kanë përbërë hartimi dhe miratimi i një sere rregulloresh dhe udhëzimesh të karakterit organizativ apo teknik dhe që synojnë mirë funksionimin e institucioneve përkatëse dhe bashkërendimin institucional të veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit. Hartimi dhe miratimi i këtyre akteve, zgjeron dhe forcon bazën ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

9.3 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM), Nr. 03/L-214)

Ky ligj ka për qëllim parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Ky ligj gjithashtu përcakton rregullimin e procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor, dhe siguron që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin janë ofruar dhe janë marrë parasysh. (Neni 1) Fushëveprim i këtij ligji janë Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis -VNM, identifikimi, përshkruarja dhe vlerësimi në mënyrë të duhur i rrethanave të secilit rast individual, efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndonjë projekti në:

- ✓ Njeriun, botën bimore dhe shtazore;
- ✓ Tokë, ujë, ajër, klimë dhe peizazh;
- ✓ Të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore;
- ✓ Ndikimet e ndërsjella të elementeve të cekura më lartë. (Neni 3)

Ligji i VNM është një nga aktet ligjore me te rëndesishem per parandalimin e ndotjes apo dëmtimit te mjedisit nga aktivitet humane. Ky ligj kërkon bërjen e një vlerësimi te përgjithshëm, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve ose veprimtarive qe kërkojnë te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis.

9.4 Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), Nr. 03/L- 230)

Qëllimi i këtij ligji është që: Me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ky ligj gjithashtu përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, (në tekstin e mëtutjeshëm VSM) perms integrimit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

(Neni 1) Fushëveprimi

- ✓ VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të

shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis.

- ✓ Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit e mbeturinave, menaxhimit e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat, duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.
- ✓ Për planet dhe programet nga paragrafi 1. i këtij neni, me të cilat parashihet edhe shfrytëzimi i sipërfaqeve të vogla në nivel lokal ose në rastet e modifikimeve të vogla të planeve ose programeve, të cilat nuk kërkojnë procedurë të rregullt për miratim si dhe për planet ose programet të cilat nuk janë të cekura në paragrafin 2. të këtij neni, vendimin për VSM e merr autoriteti përgjegjës i planit ose programit, nëse sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj, vërteton se ekziston mundësia e ndikimit të theksuar në mjedis.

VSM nuk bëhet për planet dhe programet të cilat i dedikohen mbrojtjes së vendit, evitimit të pasojave nga katastrofat natyrore dhe për planet financiare dhe buxhetore. (Neni 3)

9.5 Ligji për vetëqeverisjen lokale

Ky ligj (Ligji Nr. 03/L-040) themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. E drejta për :

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal; janë kompetencat vetanake, të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, këto kompetenca janë përcaktuar me nenin 17 të ligjit për vetëqeverisjen lokale. Në fakt hartimi i VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës duhet merrë në konsideratë edhe ligjet tjera që kanë ndikim ose rregullojnë fushat e ndryshme të mbuluara nga Plani Zhvillimor Komunal siç janë:

Ligjin për mbrojtjen e natyrës (Ligji nr. 03/l-233) Për

mbrojtjen e ajrit nga ndotja (Ligji nr. 03/1-160) Për
mbrojtjen nga zhurma (Ligji nr. 02/1-102)
Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Ligji nr. 04/-1-027)
Për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare (ligji nr. 03/1-104)
Ligji për ujërat e Kosovës
Ligji për mbeturina (2011/04-L-060)
Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural (2009/03-L-98) Ligji
për Pesticidet 2003/20
Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës (2004/29) Ligji
për Rrugët (2003/11)
Ligji për tokat bujqësore (2005/02-L26)
Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)
Edhe disa ligje të tjera:

10. Konventat Ndërkombëtare Mjedisore

Ne kontekstin e këtij raporti, disa nga konventat mjedisore të cilat duhet marrë parasysh gjatë hartimit të VMS janë renditur me poshtë.

Konventa e Bernës; “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës” Konventa e Bazelit; “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”.

Konventa e Vjenës; “Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit” dhe Protokollin e Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Konventa e Aarhus-it; “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendim-marrje dhe për të drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.

Konventa e Espoo-s “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar”.

Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara Për ndryshimet klimatike,

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin,

Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër të mjedisit natyror të Evropës

Konventa për mbrojtjen e specieve shtegtuese të kafshëve të egra

Konventa për ndotjen atmosferike në distanca të mëdha

Konventa për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar

Konventa për rivlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar

Konventa e Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare
Konventa e mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre, Konventa
e Stokholmit; “Mbi ndotësit organike të qëndrueshëm”,

10.1 MMPHI – Detyrat dhe Përgjegjësit

MMPHI-ja është përgjegjëse për menaxhimin e çështjeve të përgjithshme në fushat e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Me saktësisht MMPH-ja ka për obligim zhvillimin e politikave, normave dhe standardëve si dhe koordinimin e aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit, menaxhimin e ujërave, inspektimin mjedisor dhe planifikimin hapësinor. Gjithashtu është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe legjislacionit që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimit hapësinor.

MMPH-ja harton politika në këto fusha:

Mbrojtja e mjedisit;

Administrimi i integruar i ujërave;

Zbatimi i ligjit për ndërtim dhe hartimi i strategjisë për fushën e ndërtimit modern; Rregullimi i fushës së Banimin dhe krijimi i politikave të zhvillimit të qëndrueshëm; Efikasiteti dhe modernizimi i sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit; Veprimi operativ i inspektoratit për zbatimin e ligjit për inspektim të mjedisit;

Menaxhimi efikas i mbeturinave;

Hartimi i planit hapësinor të Kosovës;

Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore;

Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi aktiv në iniciativat Evropiane dhe ndërkombëtare për sektorin e mjedisit;

Bazuar në faktin se gjendja e mjedisit në Kosovë është larg standardëve mjedisore të Bashkimit Evropian, gjendje kjo e krijuar si rrjedhojë e zhvillimeve të paplanifikuara, mungesës së planit hapësinor, menaxhimin e dobët të mbeturinave industriale dhe shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i resurseve natyrore që ka rezultuar në degradimin e mjedisit deri në përmasa shqetësuese, përfshirë këtu edhe zvogëlimin e biodiversitetit.

E gjithë kjo që u theksua tregon se përmirësimi i gjendjes në mjedis dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mjedisin janë sfida të cilat kërkojnë zgjidhje në mënyrë që të behët e mundur, në radhë të parë ngritja e kualitetit të jetës së qytetarëve por edhe avancimi, harmonizimi dhe integrimi i standardeve kombëtare mjedisore me standardet e Bashkimit Evropian.

MMPHI-ja synim ka këto objektiva :

Përmirësimi i gjendjes në mjedis ;

Menaxhimi resurseve ujore ;
Planifikimi Hapësinor , Ndërtimi dhe Banimi ;
Fuqizimi i Inspektoratit

10.2 Vlerësimi i Shpenzimeve të dëmtimit mjedisor

Një analizë gjithëpërfshirëse dhe e azhurnuar e përgatitur nga Banka Botërore është prezantuar në qershor 2012. Objektivi i kësaj analize është të raportojë lidhur me gjendjen e mjedisit dhe çështjet kryesore mjedisore dhe ta vlerësojë koston shëndetësore dhe ekonomike të këtyre çështjeve. Kostot maten si për shembull ndikimet në shëndet (sëmundjet dhe vdekshmëria e hershme) dhe pastaj shprehen si kosto vjetore të dëmit ekonomik në euro dhe si pjesë e bruto prodhimit vendor (GDP). Duke i caktuar vlera monetare të degradimit të mjedisit, analiza (Banka Botërore, 2012) këtu arrin katër rezultate kryesore: `siguron një mekanizëm të dobishëm për renditjen e shpenzimeve relative sociale të formave të ndryshme të degradimit dhe ofron një mjet për dhënien prioritet problemeve të mjedisit. Ai ju ofron krijuesve të politikave një instrument për integrimin e mjedisit në vendimmarrjen ekonomike. Ai shpreh shpenzimet e dëmeve si pjesë e GDP, duke e mundësuar krahasimin me indikatorët e tjerë ekonomikë`. Ju ofron aktorëve të ndryshëm një mjet për diskutimin e rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit në aspektin ekonomik – të dobishme për të vendosur lidhur me mënyrën e ndarjes së burimeve të pakta dhe për ta ngritur vetëdijen e “çmimit të të bërit asgjë” lidhur me problemet urgjente të mjedisit.

Sipas raportit (Banka Botërore, 2012) kostoja vjetore e degradimit të mjedisit në Kosovë vlerësohet të jetë ` 123 milionë €– 323 milionë € më 2010, me një vlerësim mesatar prej 221 milionë €. Kjo kosto është e barasvlershme me 2.9–7.7 për qind të GDP, me një mesatare prej 5.3 për qind. Kostot janë tregues dhe jo shifra të sakta, meqë ka mungesa të mëdha të të dhënave, disa të dhëna nuk janë azhurnuar së fundi – për shkak të historisë së trazuar të vendit – dhe nuk mund të jepen shifra në para të të gjitha ndikimeve. Me kostot vjetore prej 221 milionë € të degradimit të mjedisit, Kosova ballafaqohet me ndikime serioze shoqërore dhe ekonomike për shkak të aktiviteteve të menaxhuara dobët dhe do të mund të arrinte përfitime të mëdha nga veprimet riparuese për mbrojtjen dhe ruajtjen e cilësisë së mjedisit. Kostoja e ndotjes së jashtme të ajrit në zonat urbane, ku ndikimet më domethënëse të cilat i shkaktohen shëndetit vlerësohen të jenë çështje mjedisore me ndikimin më të madh – kostot e vlerësuara të dëmit sillen prej 37 milionë euro në 158 milionë euro në vit (0.89-3.76 për qind e GDP). Vlerësohet se ndotja e ajrit shkakton 835 të vdekjeve të parakohshme, 310 raste të reja të bronkitit kronik, 600 pranime në spital dhe 11,600 vizita urgjente çdo vit`. Çështje të tjera të

rëndësishme mjedisore në Kosovë të cilat janë analizuar dhe vlerësuar më tepër në Kosovë në kuadër të shqyrtimit janë cilësia e ujit, mbeturinat e ngurta, burimet e pyjeve/të tokës dhe minierat/energja e prodhimit

DRAFT

KAPITULLI III

11. Direktivat E BE-së

11.1 Direktiva e BE-së, VSM –së

Direktiva e Këshillit 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis (Direktiva VSM) u aprovua më 27.06.2001. Direktiva VSM vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Direktiva VSM nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian ..., 2001) thotë që 'planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar,) rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative'. Një VSM është i obligueshëm për planet/programet të cilat janë të shënuara në Direktivë si vijon: 'përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzim të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM); janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve'. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës. Procedura VSM mund të përmblihet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativat e arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e paparashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

11.2 Direktivat e tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore dhe të qëndrueshmërisë. Sipas Marsden (2008) 'VSM ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti meqë vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve (dhe të programeve) por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme'.

11.3 Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrorë si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Objektivi i Konventës Me qëllim që të kontribuojmë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotme të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, çdo Palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të patur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNECE mbi Qasjen ..., 1998) 'Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartojnë dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon: të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsye pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë

të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë

përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave joqeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim; të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.

11.4 Konventa Espoo dhe Protokoli i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi Mjedisin, 1991) përcakton 'obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit'. Po ashtu i formulon 'obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve'. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997.

Siç thekson Marsden (2008), 'Protokoli i Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008)'. Protokoli është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi strategjik i mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokoli po ashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokoli kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillim rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

KAPITULLI IV

12.Procesi Dhe Metodologjia E VSM-së

12.1 Metodologjia

Kryerja e VSM për programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor. Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Graqanices, është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga

zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për menjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme nga zhvillimi i Planit Zhvillimor Komunal të Graqanices.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis dhe ligjin për VSM, i cili është transpozimi i direktivës së BE.

VSM do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- përshkrim të vizionit, priritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani ;
- përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.

- një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

Plani Zhvillimor Komunal për numrin e madh dhe diversitetin e gjere te problematikes qe trajton, kërkon konsultimin e një game te konsiderueshme dokumentacioni. Behet fjale për plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektorë te ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përveç materialeve qe dispononte vete Grup hartues i VSM-s, u siguroa nga komuna e Graqanices në bshkëpunim me MMPH dhe institucione dhe organizata te shoqerise civile tjera. Me poshtë po rendisim disa nga dokumentat kryesore qe u përdoren ne trajtimin e aspekteve te ndryshme mjedisore për komunën e Graqanices dhe me gjere.

12.2 Literatura dhe burime e informimit për VSM-en

Materiali që përben detyrën e projektimit, sqaruar në dokument si Plani Zhvillimor i hartuar nga grupet punuese, trajton ne mënyre serioze problemet mjedisore te komunës së Graqanices.

Ky dokument nder te tjera përmban informacion lidhur me shtrirjen gjeografike, gjeologjinë, sizmiken, hidrologjinë, hidrografinë, mbetjet e natyrave te ndryshme, cilësinë e ajrit, ndotjen e burimeve ujore, ekonominë, infrastrukturën, transportin, urbanistiken, informacion mbi sektorët socio-ekonomik. Ne përgjithësi materiali është i kompletuar, në veçanti në trajtimin e problemeve mjedisore me te cilat përballet komuna. Ai përmban të dhëna analitike mbi mjedisin fizik, mbetjet, cilësinë e ajrit dhe te ujërave sipërfaqësore, etj.

Plani hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në mjedis kanë përcaktuar vizionin për mjedisin i cili përkufizohet si: zhvillimi i qëndrueshëm i vendit duke mbrojtur pasuritë natyrore nga ndotja dhe dëmtimi dhe promovimi i vlerave mjedisore. Për realizimin e këtyre perspektivave, investimet për mbrojtjen e mjedisit me qellim qe standardet e Bashkimit Evropian te mund te arrihen brenda viteve te ardhshëm do te fokusohen ne fushat e mëposhtme:

- Trajtimi i ujërave te ndotura;
- Menaxhimi i mbetjeve te ngurta dhe ndërtimi i vend-depozitimeve sipas standardeve te BE;
- Mbyllja ne zonat e ndryshme e vend-depozitimeve ekzistuese;
- Rehabilitimi i tokave te ndotura dhe burimeve te ndotjes;
- Përmirësime teknologjike ne objektet industriale

Drejtimet e mësipërme për rehabilitimin dhe mbrojtjen e mjedisit, janë probleme prioritare për komunën e Graqanices. Plani Zhvillimor Komunal i Graqanices paraqet një plan të hapësirës së

Graçanices për vitin 2022-2031. Ai nënvizon gjithashtu edhe nevojën për të adresuar boshllëqet financiare, njerëzore e të burimeve institucionale për një ekzekutim efektiv të planit.

Mbi bazën e programit të Qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, ajo përcakton edhe qëllimet të cilat në mënyrë të përmbledhur janë:

- Përbushja e standardeve të kërkuara (BE, Organizata Botërore e Shëndetësive - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbeturinat urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës;
- Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese apo substanca të cilat shkatërrojnë shtresën e ozonit, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;
- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona evropiane dhe ndërkombëtare;
- Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe;

Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve. Pothuajse të gjitha këto probleme mjedisore për të cilat Plani ka përcaktuar synimet, janë problem me të cilat ndeshet edhe komuna e Graçanices Zbutja dhe zgjidhja e tyre përben një kontribut madhor në realizimin e këtij Plani.

Për një vlerësim sa më real të situatës mjedisore në komunën e Graçanices dhe luhatjen e saj në vite, krahas të dhënave për problematiken mjedisore të Komunës të nxjerra nga Detyra e Projektimit (Plani Zhvillimor Komunal), informacione më të gjëra dhe sistematike të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, zhurmave, menaxhimit të mbetjeve, etj, u gjeten në Raportet e Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenta tjera të nivelit qendrorë, përgatitur nga institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

12.3 Konsultimet gjatë VSM-së, me përfaqësues te institucioneve

Autoret e raportit të VSM-se për PZHK-se, të komunës së Graqanices kanë zhvilluar konsultime në shumë takime dhe mbledhje me përfaqësues me institucione të ndryshme në kuadër të vlerësimit strategjik të PZHK-së. Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve profesionale të qeverisjes komunale dhe qendrore, si edhe botes akademike dhe eksperte të pavarur kanë zhvilluar një numër të konsideruar të mbledhjeve deri në finalizimin e PZHK-së, që nga fillimi deri tek debatet mbi zgjidhjet hapësinore apo infrastrukurore.

Autoret e VSM, kanë marrë për baze rrugën zhvillimore të PZHK-se, duke u bazuar në shënimet zyrtare të këtyre mbledhjeve si dhe shqyrtimin e plotë të materialit të PZHK-se, nga autoret në kuadër të përgatitjes së raportit të VSM. Në mënyrë të ngjashme, Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve të qeverisjes komunale dhe qendrore, me përfaqësues edhe të shoqërisë civile dhe sektorit privat gjatë disa takimeve kanë debatuar për vizionin e zhvillimit të komunës në nivel më të gjere. Edhe shënimet e këtyre takimeve janë shqyrtuar nga autoret e raportit të VSM-se.

Nga proces-verbalet e mbledhjeve dhe takimet me anëtare të Grupeve punuese të komuna e Graqanices, si edhe me Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit pranë kësaj komune, janë marrë informacione dhe të dhëna të ndryshme që lidhen me shtrirjen e komunës (gjeografia), projeksione të popullsisë në zona të ndryshme të komunës, zonimin, peizazhin, infrastrukurën rrugore, zonat rekreative, zonat e ndotura, menaxhimin e mbetjeve, infrastruktura e ujit të pijshëm, ujërave të zeza dhe të bardha, zonat e parkimit. Këto informacione dhe takime kanë ndihmuar grupin e hartimit të VSM-s, të fokusohet më mirë në zona ekzistuese të Komunës dhe sipërfaqe që mendohet të shtohen, ku parashikohen zhvillime të caktuara.

Gjithashtu takime janë realizuar me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur problematiken mjedisore në komunën e Graqanices, zonat e ndotura mjedisore (hot spote) dhe zonat me rëndësi ekologjike. Këto takime kanë ndihmuar autoret veçanërisht në hartimin e kriterëve kufizuese mjedisore.

KAPITULLI V

13.Mjedisi

13.1 Gjendja e mjedisit

Gjendja e mjedisit në komunën e Graçanicës përcaktohet nga kushtet e saj natyrore, struktura rurale, aktivitetet ekonomike, komunikacioni dhe proceset socio-ekonomike që zhvillohen në mjedisin e saj. Përqendrimet mesatare vjetore të gazrave ndotës në ajër për vitin 2011 janë marrë nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Stacioni i testimi të cilësisë së ajrit ndodhet në Prishtinë, me një diametër prej 10 km² (të dhënat PM10 -57,83 ng/m³; 3- 49,41 ng/m³; SO₂ - 19,6 ng/m³; CO 3784,55 ng/m³; NO₂- pa të dhëna). Nuk ka teste për ndotjen e ajrit dhe tokës në territorin e komunës, por nga përvoja mund të konstatohet se ajri në Graçanicë është i ndotur nga deponia "Jalovina" e pjesës tjetër të uzinës së minierës në Kishnicë. Gjithashtu, ndotësi kryesor i ajrit në të gjithë territorin e bashkisë dhe burim zhurmash është trafiku që rrezikon më shumë popullsinë, si në zonat qendrore ashtu edhe në brezin e autostradave.

13.2 Ndotësit kolektivë

Sipas përkufizimit, ndotësit kolektivë ose vendbanimet që kanë mbi pesëdhjetë (50) amvisëri me qasje të përbashkët në kanalizim ose gropë septike.

Shumica e vendbanimeve furnizohen me ujë të pijshëm nga liqeni i Badovcit, por fshatrat (Batushë, Radevë, Suhadoll, Skulanevë, Lepinë), të cilat gjenden edhe në komunën e Graçanicës, janë furnizuar me ujë të pijshëm nga puset ose burimet natyrore të afërta. Puset e fshatit janë të lidhura me hidroforet, nëpërmjet të cilave banorët vendas përdorin ujin për përdorime të shumëfishta. Hidroforet funksionojnë me ndihmën e energjisë elektrike dhe meqë ndërprerjet e energjisë elektrike janë të shpeshta, banorët e këtyre vendbanimeve shpesh mbeten pa ujë. Ky ujë në përbërjen e tij përmban gurë gëlqerorë dhe në disa vende është bakteriologjikisht i papërshtatshëm për pije, gjë që rrezikon shëndetin e njeriut. Në shumë fshatra ende ka gropa septike, të cilat rrezikojnë ujin e destinuar për jetën e përditshme.

13.3 Ndotja e ujit

Ujërat e zeza të Graçanicës derdhen në gjashtë marrës të ndryshëm të ujit. Pjesa më e madhe e ujërave të zeza shkon në Graçankë, Žegovka, Janjevka, Sušički potok, lumin Prištinka, pastaj në Me kërkesë të Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit të Komunës së Graçanicës, më 9 korrik 2021, së bashku me Inspektoratin e MMPHI-së dhe përfaqësuesin e IHMK-es, Agron Shala, morëm dy (2) mostra për testim, qëllimi i të cilave ishte monitorimi i ujit nga lumi Graçanka në dalje nga Graçanica(1 mostër) dhe në fshatin Llapnasell (2 mostra). Në tabelat e mëposhtme, mund të shihni vlerat e rezultateve të matura në terren dhe në laborator.

Data e marrjes së mostrave :09.07.2021.		Shenja	Njesia matese	UA 30/2014 MMPH për kushtet, mënyrën, parametrat e derdhjes së ujërave të zeza në rrjetin publik të kanalizimit dhe trupin uJOR	Dalja nga Graçanica
Koha e marrjes së mostrave: 13:35					
1	Temperatura e ujit	T _U	0 _C	30 ⁰ C	22.8
2	vlera e PH	pH	0-14	6.5- 9.0	7.42
3	Përçueshmëria elektrike	PE	µS/cm	Pv	2166
4	nda totale e tretshme	MTT	mg/L	Pv	1086
5	E turbullt	TUR	NTU	Pv	12.6
6	Sediment – sediment	SED	ml/l	0.5	1.9
7	Erë	Aro	pa/me	Pv	lehtë
8	Ngjyra	Ngj	pa/me	Pv	hiri
9	Oksigjeni i tretur	OT	mg/L	Pv	0.18
10	Ngopja me oksigjen	NgO	%	Pv	1.7
11	Lënda totale e pezulluar	MTS	mg/L	35-60	268
12	Kërkesa kimike për oksigjen	SHKO	mg/L	125	373
13	Kërkesa biokimike për oksigjen	SHBO ₅	mg/L	25	210
14	Totali i karbonit organik	KTO	mg/L	Pv	115
15	Detergjentët	DET	mg/L	2.2	6.7
16	Nitritet	NO ₂ ⁻	mg/L	0.6	0.19
17	Nitratet	NO ₃ ⁻	mg/L	20	0.7
18	Amoniumi	NH ₄ ⁺	mg/L	10	1.86
19	Fosfatet	4 PO ₄ ³⁻	mg/L	1.0	2.30
20	Azoti total	NT	mg/L	10	13.9
21	Fosfor total	PT	mg/L	2.0	6.63
22	Sulfatet	4 SO ₄ ²⁻	mg/L	400	940
23	Kloruret	Cl ⁻	mg/L	400	51.1

24	Cianidi	CN ⁻	mg/L	0.01	< 0.002
----	----------------	-----------------	------	------	---------

Tabela 2. Rezultatet e mostrës nr.1 në dalje të Graçanicës

Ndotja e ujit është rritur për shkak të derdhjes së ujërave të zeza në ujë, duke hedhur mbeturina, ndërsa për shkak të përdorimit të rërës dhe zhavorrit, toka po lahet. Impiantet që përdoren për përpunimin e ujërave të zeza të qytetit nuk eZK istojnë në asnjë vendbanim. (Burimi: SPUZS për RPO Graçanica)

Ujërat e zeza nga Graçanica derdhen në 4 recipientë të ndryshëm. Ngarkesa më e madhe është lumi Graçanka me rreth 10.500 banorë, i ndjekur nga Sitnica me rreth 1.660 banorë, Perocka dhe Žegovci me rreth 1.233 dhe Janjevka me rreth 600 banorë.

13.4 Ndotja e ajrit dhe e tokës

Përveç testimit të cilësisë së ajrit në stacionin e Prishtinës, i cili mbulon një sipërfaqe me diametër prej 10 km, në komunë nuk ka teste për ndotjen e ajrit dhe tokës, por nga përvoja e përditshme mund të thuhet se ajri dhe toka janë të ndotura nga deponia në Kishnicë në pjesën qendrore dhe në veri, ndërsa pjesa perëndimore nga minierat sipërfaqësore të qymyrit. Mund të ketë ndotje që nga koha e bombardimit, por komuna nuk ka të dhëna ose nuk ka akses në ato të dhëna.

Një problem i rëndësishëm janë mbetjet mjekësore, të cilat hidhen së bashku me llojet e tjera të mbetjeve. Një nga deponitë kryesore është diga e mbeturinave të minierës së Kishnicës. Ky deponi është sfida kryesore mjedisore me të cilën përballet bashkia.

13.5 Grumbullimi dhe Menaxhimi i Mbeturinave

Komuna e Graçanicës ka një plan për menaxhimin e mbeturinave dhe në korrik të vitit 2020 mandati për këtë zonë i është besuar ndërmarrjes komunale të licencuar “Ekologjia”, ndërsa deri atëherë shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave i ka kryer kompania rajonale “Pastrimi”. Si në zonat e tjera rurale në Kosovë, shërbimet komunale janë shumë të dobëta.

Komuna e Graçanicës është themeluese dhe pronare 100% e kompanisë “Ekologjia”. Kompania drejtohet nga një Bord Drejtues i përbërë nga 5 anëtarë, njëri prej të cilëve është drejtori ekzekutiv dhe zgjidhet nga Bordi. Mbikqyrjen mbi punën e kompanisë e kryen komisioni komunal prej tre anëtarësh i aksionarëve të emëruar nga Kuvendi Komunal dhe Komuna e Graçanicës në pajtim me ligjin.

Kompania ka marrë plotësisht detyrimin e menaxhimit të mbetjeve nga kompania “Pastrimi” dhe sot kryen 100% të të gjitha detyrave që ishin në juridiksionin e kësaj kompanie. Sasia e mbetjeve të grumbulluara në të gjithë bashkinë arriti në rreth 400 t në muaj, nga 300 t fillestare. Arsyeja e kësaj rritjeje është se “Ekologjia” ka përfshirë pothuajse të gjithë përdoruesit (familjet individuale), gjë që nuk ka qenë më parë, por ka nisur edhe procesin e largimit të plehrave nga territori i komunës sonë, që ndodhej në deponi ilegale.

Të gjitha mbeturinat e grumbulluara dërgohen kolektivisht në deponinë rajonale në Mirash si komunale sepse deri më sot nuk janë krijuar kushte për ndarjen dhe ndarjen eventuale të mbeturinave të riciklueshme. Është gjithashtu diçka për të cilën kompania do të përpiqet në periudhën në vijim. Përveç mbetjeve nga familjet dhe bizneset, të gjitha mbeturinat e prodhuara nga institucionet në komunën tonë, duke përfshirë qendrat shëndetësore (spitale, qendra shëndetësore), aktualisht trajtohen si mbeturina komunale dhe ky është një problem serioz.

Është e nevojshme të vepohet në mënyrë aktive në drejtim të ndarjes dhe asgjësimit të veçantë të mbetjeve mjekësore. Shoqëria e shërbimeve publike "Ekologjia" është një shoqëri publike lokale me strukturë dhe detyra komplekse. Siç u tha më herët, JKP "Ekologjia" DD i kryen aktivitetet nga mandati i saj në territorin e të 17 vendbanimeve dhe subjekteve afariste në territorin e komunës. Potenciali për rritje, por edhe hapja e mundësive për punësime të reja është në pjesën e territorit që simbolikisht quhet “Autostrada” ku operojnë më shumë se 80% e bizneseve. Kjo pjesë e territorit komunal është kryesisht e banuar nga komuniteti shumicë dhe deri në shfaqjen e Ndërmarrjes Publike “Ekologjia” ishte e mbuluar në mënyrë joadekuate nga shërbimi, për shkak të mungesës së një kompanie vendore dhe politikës dhe mënyrës së organizimit të menaxhimit të mbeturinave, gjë që ndikoi negativisht tek klientët dhe vetë komuna. JKP “Ekologjia” ka bërë hapat e parë në këtë drejtim dhe në periudhën e ardhshme do të ofrojë mekanizim shtesë dhe punësim të punëtorëve shtesë për të “mbuluar” atë pjesë të territorit ku potenciali është më shumë se 500 përdorues individualë dhe 400-500 biznese shtese. cJKP "Ekologjia" është kompani publike lokale e themeluar për të kryer aktivitete me interes publik dhe për të ofruar shërbime komunale publike në komunën e Graçanicës dhe më gjerë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Sipas Statutit të JKP “Ekologjia” SH.A Graçanica është kompani e angazhuar në ofrimin e shërbimeve komunale me interes të përgjithshëm dhe lokal, si në vijim:

- Mbledhja, largimi dhe asgjësimi i mbeturinave;
- Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra dhe publike;
- Pastrimi dhe largimi i deponive ilegale;

- Mirëmbajtja e rrugëve lokale;
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale në kushte dimërore;
- Mirëmbajtja e oxhaqeve të amvisërive dhe objekteve të tjera;
- Organizimi dhe mirëmbajtja e tregjeve;
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave lokale;
- Organizimi i funeraleve dhe krijimi i monumenteve;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik të rrugëve;
- Mirëmbajtja e rrjetit lokal të kanalizimeve;
- Shërbime për makineritë e ndërtimit që kanë të bëjnë me aktivitetet komunale, punimet tokësore, gërmimi i kanaleve të shiut dhe kanaleve për instalimin e ujës-jellës, kanalizimit dhe të tjera, largimi i mbeturinave ndërtimore dhe dheut, rregullimi i hapësirave publike.

14. Hapësirat publike dhe të gjelbra

Pas formimit të Komunës janë realizuar projekte, ndër të cilat janë projektet e ndërtimit dhe rregullimit të shesheve, parqeve përkujtimore, parqeve publike, parqeve për fëmijë: Graçanicë, Badovac, Sushicë, Kishnicë, Llaplla Sellë, Çagllavicë, Uglarë, Radevë, Skulanevë, Dobratinë, D. Gushterica, G. Gushterica I Livadje. Ka ende zona të gjelbra që duhen rregulluar, gjelbëruar dhe ringjallur. Zhvillimi në të ardhmen dhe progresi në punë do të krijojë mundësinë e një numri më të madh projektesh që do të rinovojnë dhe rregullojnë parqe të reja



Figura 1. Parku Memorial në Graçanicë




Figura 2. Parku memorial dhe parku i fëmijëve në Livaxhë



Figura 3. Sheshi Dobratin



Figura 4. Sheshi Simonida në Graçanicë




Fig.3 Harta e hapsirave te gjelberta

14.1 Hapësirat e Gjelbra




Foto 3 . Shën Princ Llazar-Gushtericë e Poshtme



Foto 4. Shën Dhimitri -Shushicë



Foto 5. Shën Dhimitri – Dobratinë



Foto 6. Shën Petka -Lapnasellë

14.2 Deponitë ilegale

Është e mundur të përdoret transporti publik, transporti dhe ruajtja në landfillin sanitar dhe ofrimi i shërbimeve tematike për përdorimin e shërbimeve komunale për përdorimin e markave tregtare. Deponimi i paligjshëm i mbeturinave është një problem i zakonshëm në Kosovë, i pranishëm në të gjitha komunat. Një vlerësim i fundit i bërë në vitin 2017 identifikoi 1,572 deponi ilegale në 38 komuna. Deponitë e paligjshme që janë identifikuar klasifikohen sipas madhësisë dhe llojit të mbetjeve, pra: landfille të mëdha, të mesme dhe të vogla, në bazë të sasisë së mbetjeve të

depozituara dhe sipërfaqes së zënë. Sipas llojit të mbetjeve, deponitë ilegale klasifikohen si: (a) venddepozitime për mbetjet shtëpiake; (b) deponitë për mbetjet e ndërtimit dhe prishjes; (c) deponitë e mbetjeve të rrezikshme; (d) deponitë e mbetjeve të mëdha; dhe (e) landfille të tjera. Nga 1572 landfille ilegale të identifikuar, 45% janë deponi të mëdha,

Numri i deponive, madhësia e tyre, lloji i mbetjeve si dhe plani i depozitimit janë përgjegjësi e dy departamenteve brenda komunës (inspektimet dhe shërbimet publike). Këto shërbime kanë të dhëna dhe janë më kompetente për të futur tekst dhe statistika në këtë seksion.

Në zonën e komunës së Graçanicës ka një numër të madh të deponive ilegale, të cilat janë krijuar nga pakujdesia njerëzore. Një nga deponitë më të mëdha ilegale është një deponi afër deponive në Graçanicë. Kjo dhe deponitë e tjera të egra rrezikojnë mjedisin, sepse ndodhen pranë vendeve të banuara, kopshteve, shkollave, buzë lumenjve, buzë rrugëve etj.

Departamenti i Shërbimeve Publike është përgjegjës për largimin e deponive dhe mbetjeve ilegale, pra për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra në bashki.



Fotografia 7. Deponitë ilegale

Sterilet e minierës së Kishnicës paraqesin një katastrofë ekologjike të komunës dhe rajonit, si dhe një kërcënim të vazhdueshëm të degradimit të mjedisit. Rrezikimi i mjedisit reflektohet në ndotjen e rrjedhave ujore, ajrit dhe tokës përreth. Ndotja që ka ndodhur që nga viti 1965 rrezikon si rrjedhat ujore përmes erozionit të mbetjeve, ashtu edhe ajrin duke fryrë erëra që shpërndajnë pluhurin e mbetjeve, por edhe tokën bujqësore aty pranë ku depozitohet pluhuri i depozituar. Erozioni është një fenomen që haset shpesh në sterilat. Ndër aksidentet e përshkruara në raportin e

Komisionit Ndërkombëtar për Digat e Mëdha dhe Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, janë shënuar vetëm dy nga ish-RSF Jugosllavia, aksidenti në mbetjet e minierës së plumbit dhe zinkut "Brskovo" nga Mojkovac (Mali i Zi) dhe argjinaturës së çrregullt të pjerrësisë në mbetjet e minierës së Kishnicës. Aksidenti ka ndodhur në shtator të vitit 1988, kur ka ndodhur një situatë e tejmbushjes së ujit rreth 10,000 m mbi kurorën e digës dhe mbetjeve. Toka e punëshme dhe rreth një duzinë shtëpi janë përmbytur. Derdhja ndodhi si rezultat i neglizhencës në shfrytëzimin e mbeturinave dhe incidenti u politizua kryesisht (RI, 1988).

14.3 Ndotja nga zhurma

Rruga kryesore Prishtinë – Gjilan në gjatësi prej 48 km prek kryesisht zonën e banuar pranë rrugës në të cilën ndodhet manastiri i Graçanicës duke lëshuar vazhdimisht vibrime, smog dhe pluhur, gazra të mbeturinave, zhurmë.

Matjet e kryera në periudhën 26 gusht deri më 5 shtator 2011 kanë konstatuar se niveli mesatar i zhurmës gjatë ditës ka qenë 78dB, që është 13dB më shumë se niveli i lejuar.

Pika matëse	Niveli mesatar i zhurmës / ditë	Tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës / ditë	Matja më e lartë e zhurmës	Niveli mesatar i zhurmës / natë	Tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës / natë
Sheshi Simonida Një vend pranë manastirit të Graçanicës	78dB	13dB	98dB	67dB	12dB

Tabela 3. Niveli i zhurmës akustike i rrugës kryesore Prishtinë - Gjilan, e cila kalon pranë manastirit të Graçanicës

14.4 Përmbytjet

Sipas studimeve, Graçanica është pjesërisht e prirur ndaj përmbytjeve, tërmetejeve, zjarrit, erozionit, breshrit dhe transportit të mallrave të rrezikshme. Zonat e rrezikuara nga përmbytjet janë përgjatë lumit Sitnica. Argjinaturat e lumenjve janë ndërtuar në të dy anët e lumit, por gjatë reshjeve të gjata dhe të dendura dhe kur bora shkrihet gjatë dimrit, uji depërton në argjinatura. Lumenjtë dhe përrenjtë e tjerë janë të ngushtë dhe depozitimi i mbetjeve të ngurta shkakton përmbytje. Uji

atmosferik gjithashtu shkakton shira të dendur në disa zona fushore. Kosova ka një rrjet hidrografik kryesisht autokton me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 10,907 km² që përafërsisht korrespondon me kufijtë administrativë të Kosovës. Burimet e lumenjve të Kosovës janë autoktone në pjesën e sipërme të shtratit të lumit, përveç paraqitjes së erozionit për shkak të pjerrësisë së terrenit dhe përbërjes gjeologjike të terrenit, nuk shkakton ndonjë dukuri negative në aspektin e vërshimeve. Përmbytjet janë të pranishme në periudhën kur reshjet atmosferike janë të shumta gjatë stinës së pranverës, kur reshjet janë më të forta dhe të kombinuara me shkrirjen e borës dhe gjatë stinës së vjeshtës. Përmbytjet ndodhin natyrshëm rreth pellgjeve të lumenjve, veçanërisht në bashkimin e degëve të lumenjve me lumin kryesor, ku akumulimi i sedimentit nga degët e lumenjve mund të shkaktojë bllokim të pjesshëm të rrjedhës normale të lumit kryesor dhe të shkaktojë devijimin e vijës së lumit dhe përmbytje në tokën bujqësor.

14.5 Tërmetet

Kosova ndodhet në një zonë shumë sizmike të prekur nga tërmetet në të kaluarën, zonë e prekur nga tërmetet autoktone që kanë prodhuar një thellësi prej 15-20 km në vend. Struktura tektonike dhe epiqendrat e tërmeteve me magnitudë $M > 4.0$ që goditën Kosovën në vitin 2009. Ato janë paraqitur në hartën e bashkangjitur. Të dhënat për tërmetet nga e kaluara dëshmojnë qartë se shfaqja e tërmeteve katastrofike në disa pjesë të Kosovës ishte evidente shumë herët. Ndër tërmetet më të forta që goditën Kosovën dhe rrethinën e saj përmendim:

14.6 Zjarri

Zona pyjore është e prirur ndaj zjarreve gjatë stinëve të verës. Gjithashtu, arat pas korrjes së grurit, në shumë raste vihen në flakë nga fermerët. Ky aktivitet në stinën e verës në shumë raste sjell zjarre pranë fushave.

14.7 Erozioni

Erozioni kërcënon prosperitetin e krijuar dhe të planifikuar të njerëzimit. Ai është i pranishëm kudo në territorin e Kosovës dhe paraqitet në forma të ndryshme, si erozioni sipërfaqësor i tokës, brigjet e lumenjve, përrrenjtë, transporti i depozitave të ngurta dhe rrëshqitjet e tokës, rrëshqitje masive apo të lokalizuara si dhe degradimi fizik dhe kimik i tokës. Shkaqet e erozionit shkaktohen nga një kombinim faktorësh si pjerrësia, klima, përdorimi joadekuat i tokës, mbulimi i bimëve dhe shkatërrimi i mjedisit, si: djegia e pakontrolluar ose shpyllëzimi, mungesa e investimeve në mbrojtjen e tokës, ndërtimi i digave malore, pyllëzimet e reja etj.

Bazuar në njohuritë nga hulumtimi në terren dhe hartat e marra nga EULUP, zona pyjore është e prirur ndaj erozionit. Shkaktarët e erozionit janë shpyllëzimi dhe minierat në zonën e mbetjeve.

14.8 Asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Komuna e Graçanicës është shumë e pasur me trashëgimi kulturore dhe historike, këto janë trashëgimia që e kemi trashëguar nga të parët tanë dhe që duhet ta ruajmë e t'ua përcjellim brezave të ardhshëm. Në territorin e komunës ka një sërë kishash dhe manastire ortodokse serbe, dhe disa prej tyre janë ndërtuar nga sundimtarët mesjetarë serbë (Manastiri i Graçanicës), më pas aty janë ndërtuar shumë monumente kulturore dhe historike, dhe në territorin e saj është i famshëm lokaliteti arkeologjik i Ulpianës. Për shkak të numrit të madh të kishave dhe manastireve, monumenteve kulturore dhe historike dhe lokacioneve arkeologjike, të cilat gjenden në komunën e Graçanicës, aktualisht vetëm manastiri i Graçanicës është nën një zonë të veçantë të mbrojtur, monumentet historike dhe objektet arkeologjike të mbrohen në të ardhmen.



Fotografia 3. Institucioni parashkollor në Llapnasellë



Fotografia 4. Institucioni Parashkollor në Dobratin



Fotografia 5. Institucioni parashkollor në Graçanicë



Fotografia 6. Shkolla fillore "Krajl Milutin" në Graçanicë



Fotografia 7. Shkolla fillore "Miladin Mitić" në Llapnasellë



Fotografia 8. Shkolla fillore "Braça Aksiq" në Suhadoll

15.Kultura

Ruajtja e traditave kulturore dhe popullore dhe ruajtja e objekteve kulturore e fetare-manastire dhe kisha ndër shekuj, është pjesë e trashëgimisë kulturore të popullit të Kosovës. Vendbanimi i Graçanicës karakterizohet nga manastiri i Graçanicës, i cili me shekuj ka mbledhur popullsinë e zonës dhe ka qenë qendër e arsimit dhe e ngjarjeve kulturore. Duke marrë parasysh se Graçanica deri në formimin e komunës ka qenë zonë rurale, vetëm Shtëpia e Kulturës ka pasur qendër kulturore, e cila ka qenë qendër e ngjarjeve kulturore për disa dekada që nga viti 1948. Ngjitur me Shtëpinë e Kulturës në Graçanicë, shtëpi të kulturës ka edhe në fshatrat tjera të komunës sonë. Bëhet fjalë për hapësira me shumë qëllime me një sallë funksionale për ngjarje kulturore dhe argëtuese, biblioteka, hapësira të këshillit vendor, galeri dhe hapësira sociale. Aktualisht janë në funksion shtëpi të kulturës në Graçanicë, Llapnasellë (rinovuar në 2018), Gushtericë të Poshtme (rinovuar në 2020), Preoc, Batushë, Dobratin, Çagllavicë, si dhe një objekt i ri i ndërtuar rishtas në Kishnicë.

15.1 Asetet e trashëgimisë kulturore

Trashëgimia kulturore është një nga bazat kryesore për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal dhe mbrojtja e ruajtja e saj është domeni më i lartë i njerëzimit. Resurset më të rëndësishme kulturore dhe turistike në komunën e Graçanicës janë:

- Manastiri i Graçanicës (ndërtesë madhështore e shekullit të XIV, e ndërtuar nga Mbreti Milutin në vitin 1321. I kushtohet Virgjëreshës Maria e Bekuar);
 - Vendi arkeologjik i Ulpianës, mbetjet e një qyteti romak dhe të hershëm bizantin, i themeluar në mesin e shekullit II pas Krishtit;
 - Lokalitete të paeksploruara arkeologjike në afërsi të Graçanicës;
 - Kishat në komunën e Graçanicës (kisha të shumta të objekteve të ndryshme të vendosura pothuajse në çdo fshat);
 - Monumentet në Graçanicë;
 - Manastiri i Vojsilovicës;
 - Vendi i ekskursionit Çeshmja;
 - Ndërtim tradicional - shtëpi të vjetra të braktisura dhe mullinj;
- Trashëgimi e pasur jomateriale që prezantohet kryesisht përmes manifestimeve të ndryshme




Fig 4 Harta e Aseteve te Trashigimis Natyore



Fotografia 3. Shtëpia e Kulturës, Graçanicë



Fotografia 4. Shtëpia e Kulturës në Llapnasellë

15.2 Harta e Asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Vendbanimet		Institucionet Kulturore			
		Emri i Institucionit	Viti i themelimit	Lagja / zona	Numri i zyrtareve (nr.)
1.	Graçanicë	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Graçanicë	4
		Biblioteka Popullore Objekti amë	-E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Graçanicë	-
2.	Badovc	Shtëpia e kulturës	2011	Badovac	-
3.	Kishnicë	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Kisnica	-
4.	Llapnasellë	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Llapnasellë	-
		Biblioteka Popullore Paralele e ndarë	-E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Llapnasellë	-
5.	Preoc	Shtëpia e kulturës	2010	Preoc	-
6.	Çagllavicë	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Çagllavicë	-
		Biblioteka Popullore Paralele e ndarë	-E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Çagllavicë	-
7.	Sushicë	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Sushicë	-
8.	Batushë	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Batushë	-
9.	Dobratin	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Dobratin	-
10.	Gushtericë Poshtme	Shtëpia e kulturës	E themeluar para formimit të K. Graçanicës	Gushtericë Poshtme	-

Tabela 4. Institucionet kulturore, (shtëpi të kulturës, qendra rinore, bibliotekë, kinematë, teatrot, muzetë, galeria e arteve, ekspozitura), regjistri sipas vendbanimeve – 2021

Vendbanimet		Institucionet kulturore - kapacitete hapësinore (m ²)			
		Emri i Institucionit	Sipërfaqja parcelës (m ²)	Sipërfaqja ndërtuar (m ²)	Sipërfaqja e lirë (m ²)
1.	Graçanicë	Shtëpia e Kulturës	7.000,00	3.730.00	3.270.00
2.	Badovc	Shtëpia e Kulturës	529	167	486
3.	Kishnicë	Shtëpia e Kulturës	4.000	300	3.700
4.	Preoc	Shtëpia e kulturës	2.000	160	1.840

Tabela 5. Tabela e Institucionet Kulturore, kapacitetet hapësinore – 2021

15.3 Shpërndarja e ndërtesave të kulturës dhe rinisë

Me poshte ne harte jane te paraqitura shtepit e kultures , rinise dhe Biblotekat ne te gjitha lokacionet ne komunen e Graçanicës





Fig 5 .Harta e shperndarjes se ndertesave te kultures dhe rinise



Fotografia 5. Sallë moderne sportive në Llaplasellë




Fotografia 6. Fusha me shumë qëllime në sallën e sportit



Fotografia 7. Hapësirë parkimi përballë sallës së sportit në Llapnasellë



Fotografia 8. Fusha tenisi dhe dhomat e zhveshjes



Fotografia 9. Qendra Rinore e sapondërtuar në Graçanicë



Fotografia 10. Qendra Rinore në Preoc

Hapësirat publike dhe të gjelbëra dhe parqet

Pas formimit të Komunës janë realizuar projekte, ndër të cilat janë projektet e ndërtimit dhe rregullimit të shesheve, parqeve përkujtimore, parqeve publike, parqeve për fëmijë në Graçanicë, Badovc, Sushicë, Kishnicë, Llapnasellë, Çagllavicë, Uglarë, Radevë, Skulanevë, Dobratin, Gushtericë e Epërme, Gushtericë e Poshtme dhe Livaxhë. Ka ende zona të gjelbra që duhen rregulluar, gjelbëruar dhe ringjallur. Zhvillimi në të ardhmen dhe progresi në punë do të krijojë mundësinë e një numri më të madh projektesh që do të rinovojnë dhe rregullojnë parqe të reja.



Fig 6. Parku memorial dhe parku i fëmijëve

16.Harta e Hapësirave te Gjelbra



Fotografia 13. Shën Dhimitri – Dobratin




Fotografia 14. Shën Premtes -Lapnasellë

17.Asetet e Trashëgimisë Natyrore

17.1 Burimet Natyrore

Liçeni i Badovcit është akumulim artificial i ujit në lumin Graçanka, dy kilometra mbi Graçanicë, i ndërtuar që të furnizojë Prishtinën dhe rrethinën e saj me ujë. Një pjesë e liçenit të Graçanicës i takon komunës. Ndërtimi i liçenit të Graçanicës ka filluar në vitin 1963, ndërsa uji nga ai për në Prishtinë ka rrjedhur në verën e vitit 1966. Penda me një lartësi prej 52 m, gjerësi 246 m, është ndërtuar në ngushticën e Badovcit, nën malin e Androvaçës, në afërsi të minierës së Kishnicës. Liçeni është i gjatë 3,5 km, i gjerë deri 500 m, thellësia më e madhe është deri në 30 m, ndërsa vëllimi totali tij është 26 milion m³ ujë. Është i pasur me lloje të ndryshme të peshkut, kryesisht me krap dhe bërcak (klen). Gjatë ndërtimit të tij janë shpërngulur banorët e fshatit serb Novosellë, në brezin e ujërave të liçenit dhe Badovci i Vjetër, nën pendë.



Liçeni i Badovcit

Lumenjet në Komunë e Graçanicës

Komuna e Graçanicës është e pasur me burime ujore dhe nëpër komunë rrjedhin katër lumenj dhe një përrua: Graçanka, Sitnica, Prishtevka, Janjevka dhe përroi i Zegovaçit. **Graçanka** është një lum në Kosovë që rrjedh përbri manastirit të Graçanicës, nëpër vendbanimet Graçanicë, Llapnasellë, Preoc, Dobrevë e Epërme dhe derdhet në Sitnicë, në dalje nga Dobreva e Poshtme. Ai buron nën digën e liqenit të Badovcit dhe rrjedh pranë mbetjeve të minierës së Kishnicës. Derisa nuk kishte liqen, Graçanka ishte më e pasur me ujë dhe u formua nga lumenjtë dhe përrenjtë poshtë fshatit Llabjan dhe fshatit Mramor. Gjatësia e këtij lumi është 18,50 km. Është rregulluar njëpjesë e shtratit të lumit Graçanka. **Sitnica** është një nga lumenjtë më të mëdhenj në Kosovë e cila buron në pjesën juglindore të Kosovës, në malin e Zhegavacit. Gjatësia e Sitnicës është 90 km, ndërsa prurja mesatare në grykë është 9,5 m³/sek. Edhe pse lartësia mesatare e saj është 1000 m, Sitnica që rrjedh përgjatë fundit të Fushë Kosovës, ka të gjitha karakteristikat e lumenjve fushor: një rënie të vogël (0,76 %) dhe një shtrat të cekët gjarpërues nga i cili rrjedh rregullisht në nivele më të larta të ujit, duke ndryshuar shtrat.



Fig.8 Zonat mbrojtëse sanitare të ujërave

⁴⁵ Burimi: Thomas de Beyer, Prof. Vahdet Pruthi. *Përmirësimi i mbrojtjes së burimeve ujore në sistemet rurale të ujërave – Përcaktimi i kufijve të zonave të mbrojtjes sanitare të fushës puseve të ujërave nëntokësore “Konjuh” - Lipjan. Shkurt, 2017*

17.2 Përshkrim i zonave mbrojtëse ujore

Ligji për ujërat **Nr.04/L-147** dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI **Nr. 15/2017** për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit, përcaktojnë Zonat e Mbrojtura Sanitare. Këto zona janë quajtur Zonat Mbrojtëse të Ujërave Nëntokësore (ZMUN). Sipas Ligjit për Ujërat **Nr. 04/ L-147**dhe Udhëzimit Administrativ MMPHI **Nr. 15/ 2017** për zonat e mbrojtura sanitare, përdorimi i tokës dhe aktivitetet në tokë në këto zona mbrojtëse të ujërave nëntokësore janë të kufizuara në mënyrë rigorozë. Udhëzimi Administrativ liston aktivitetet e ndaluara për secilën fushë.

17.3 Definicioni administrativ për ZMUN I, Zona e I-rë Mbrojtëse Sanitare

Zonë e I-rë – Zona e Kufizimit përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit dhe objekteve ujëmarrëse si dhe zonës së drejtpërdrejt të tyre nga cfarëdo dëmtimi, ndotje ose ndikime të tjera të dëmshme të rastësishme ose të qëllimshme. Sipas nenit 10 të këtij udhëzimi, kufiri i Zonës së I-rë mbrojtëse sanitare të një burimi nëntokësor në akuifer intergranular paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujëmarrëse dhe objekteve përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit.

Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtur sanitare duhet të jetë i rrethuar me rrethojë të fortë dhe stabile, e cila duhet të jetë e lartë së paku 2 (dy) metra, në mënyrë që të pengohet hyrja e shtazëve apo e personave të pa-autorizuar. Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtur shënohet me shenja të dukshme, të cilat vendosën në hyrjet e zonës si dhe në lokacione tjera të përshtatshme të kufirit të zonës me qëllim të njoftimit të kalimtarëve se ata gjenden në afërsi të zonës së mbrojtur dhe se u ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Në këtë zonë ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë. Lejohet kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve tjera që mund të rrezikojnë cilësinë e ujit, punimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi, me ç'rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

17.4 Definicioni administrativ për ZMUN II, Zona e II-të Mbrojtëse Sanitare

Territori i zonës së II-të përfshin hapësirën jashtë kufirit të zonës së I-rë deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 50 (pesëdhjetë) ditë për të arritur te vepra ujëmarrëse. Kufiri i zonës së II-të të mbrojtur për burime dhe puse duhet të jetë së paku 100 (njëqind) metra nga zona e I-rë e mbrojtur. Kufiri i Zonës së II-të shënohet me vendosjen e shenjave të dukshme në hyrjet e zonës si

1. Kryerja e aktiviteteve nga neni 15 i këtij udhëzimi administrativ;
2. Përdorimi i plehrave kimike dhe atyre të kafshëve;
3. Përdorimi i pesticideve, herbacideve, dhe insekticideve;
4. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nukshfrytëzohen për furnizim publik;
5. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpëzeve dhe kafshëve;
6. Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale;
7. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajradhe materie të rrezikshme;
8. Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme;
9. Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës;
10. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të ketë pasoja negative në burimin e ujit.

17.5 Definicioni administrativ për Zonën III, Zona e III-të Mbrojtëse Sanitare

Territori i Zonës së III-të të mbrojtur për burimet në akuifer intergranular (Zona e Mbikëqyrur) përfshin hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të të mbrojtur deri te ujëndarësi hidrogeologjik. Në rastet kur kufiri hidrogeologjik nuk është i njohur, zona e III-të përfshin hapësirën deri te kufiri prej të cilit ujit nëntokësor i nevojiten së paku 200 (dyqind) ditë për të arritur te vepra ujëmarrëse. Kufiri i zonës së III-të duhet të jetë së paku 500 (pesëqind) metra nga vepra ujëmarrëse. Në hapësirën e zonës së III-të ndalohen kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i

aktiviteteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e burimit, dhe në mënyrë specifike:

1. Shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajuara të kanalizimit;
2. Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave, etj);

17.6 Burimet potenciale të ndotjes së fushës së puseve në Konjuh

Për të përcaktuar zonat mbrojtëse të ujërave nëntokësore është paracaktuar shkalla maksimale e prodhimit prej 84 l/s si parametër që duhet aplikuar. Zona mbrojtëse e ujërave nëntokësore duhet të jetë defanzive dhe duhet të jetë e definuar për kërkesat e ardhshme (si kërkesa e rritur për ujë). Prandaj, simulimi i linjës 50 ditore dhe zona rimbushëse që i referohet shkallës së pompimit të kohëve të fundit prej 40 l/s nuk ofron mbrojtje për rritjen e shkallëve të pompimit në nivele që teknikisht janë të mundshme apo që kanë gjasat më të mëdha për të ndodhur, për një të ardhme të afërt. Burimet potenciale të ndotjes dhe masat e propozuara i referohen simulimeve me shkallë të pompimit prej 84l/s që është teknikisht e mundshme dhe është nivel i qëndrueshëm i pompimit.

Zona Mbrojtëse e Ujërave Nëntokësore I

ZMUN I janë definuar si zona shumë të kufizuara prej 10 metër katror përreth grykës së pusit. Zona e të gjitha puseve është rrethuar me një rrethojë të madhe. Kjo zonë është në përputhje me rregulloretkosovare për ZMUN I dhe rrjedhimisht mund të shpallet si e tillë.

Zona Mbrojtëse e Ujërave Nëntokësore II

Simulimi i ZMUN II mbulon një zonë prej afërsisht 13 hektarë përreth puseve të shfrytëzimit (shtrirjanë distancë prej afërsisht 200 m deri në grykat e puseve siç është treguar në Figurën 6). Kjo zonë është shtrirja minimale që duhet shpallur si Zona mbrojtëse II dhe që kërkon mbrojtjen pasuese nga kontaminimi (ndotja) kimik dhe biologjik. Shtrirja minimale e ZMUN II është e mbuluar me zonë bujqësore dhe duhet të monitorohet dhe të mbrohet nga çfarëdo kontaminimi biologjik apo kimik.

18. VENDBANIMET

18.1 Vendbanimet joformale

Termi "Vendbanim Joformal" është përdorur për herë të parë në Planin e Zbatimit të Standardeve të Kosovës të vitit 2004, në të cilat u përkufizua se "Vendbanime joformale" janë vendbanimet njerëzore që nuk u ofrojnë banorëve të tyre mundësinë për të gëzuar të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm jetese, veçanërisht strehim adekuat."

Me nënshkrimin e Deklaratës së Vjenës në 2005, anëtarët ranë dakord për masat që do të rregullojnë vendbanimet joformale në mënyrë të qëndrueshme, e cila do të parandalonte shfaqjen e tyre në të ardhmen.

I bazuar në Ligjin **Nr. 04/L-174** për Planifikimin Hapësinor "Vendbanimi Informal" karakterizohet si vendbanim që është:

- e ndërtuar në tokë pa të drejtë pronësie,
- ka akses të pamjaftueshëm në shërbimet bazë ose mungesë të shërbimeve bazë,
- pjesëmarrja e pamjaftueshme ose mospjesëmarrja në menaxhim dhe
- banorët janë subjekt i një shkalle të lartë diskriminimi.

Komuna e Graçanicës është përballur me shumë probleme që nga dita e parë e formimit të saj. Një nga problemet është se e gjithë komuna është rurale dhe duhet rregulluar. Në bazë të kriteve të dhëna për vendbanimet joformale, në bazë të Planit Zhvillimor të miratuar më parë të Komunës së Graçanicës, është bërë një analizë e detajuar e të gjitha vendbanimeve dhe është konstatuar se në komunë janë 15 (pesëmbëdhjetë) vendbanime joformale. Shtatë vjet pas miratimit të PZHK-së, është bërë përparim i dukshëm në zhvillimin e këtyre vendbanimeve, si në aspektin social ashtu edhe në atë fizik.

Në bazë të analizave të reja të kryera dhe duke pasur parasysh projektet e realizuara, është konstatuar se disa vendbanime që në vitin 2010 ishin joformale tani kanë statusin e vendbanimeve formale. Që atëherë nuk ka vendbanime joformale në territorin e komunës së Graçanicës

18.2 Banimi

Objektet e Banimit

Nga pikëpamja e strehimit social rregullohen siç duhet çështjet që lidhen me strehimin, të cilat kanë të bëjnë me krijimin e kushteve të favorshme për ndërtimin e banesave dhe zgjidhjen e nevojave për banim, bazuar në kërkesat e familjeve dhe individëve në nevojë sociale, të zhvendosurve, çifteve të reja dhe stafit. Banesat sociale në komunën e Graçanicës rregullisht analizohen dhe kontrollohen nga gjendja në objekte, si dhe raportimi nga terreni nga punonjësit e Shërbimit të Banimit në Sektorin për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Në territorin e komunës së Graçanicës mbizotëron banimi individual. Sipas rezultateve paraprake të censusit, Byroja e Statistikave ka 35 njësi individuale (pallate banimi) për banesa sociale. Nga këto:

- Tri (3) njësi individuale për banim social kolektiv në ndërtim e sipër në Llapnasellë
- Dy (2) banesa individuale nga katër apartamente secila - gjithsej tetë (8) apartamente
- Një (1) njësi banimi individuale prej dyzet e katër (44) apartamente

Gjithsej pesëdhjetë e dy (52) njësi banesore për banim social janë në ndërtim e sipër.

Situata aktuale në terren është:

- Graçanicë - gjashtë (6) objekte kolektive të banimit social - gjithsej 130 banesa
- Llapnasellë - njëmbëdhjetë (11) - gjithsej 132 apartamente (+52 njësi banimi në ndërtim, gjithsej 184 apartamente)
- Dobratinë - dy (2) - gjithsej 28 apartamente
- Suhadoll - katër (4) - gjithsej 16 apartamente
- Gushtericë e Poshtme - tre (3) - gjithsej 12 apartamente
- Minatorët e qymyrit - Bergen - gjashtë (6) - gjithsej 22 apartamente

Komuna aktualisht ka 340 njësi banimi për banim kolektiv social (+52 njësi banimi në ndërtim në total - 392 njësi banimi).

KAPITULLI VI

19. Plani zhvillimor komunal Qëllimi dhe Objektivat e PZHK-se Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal

Plani Zhvillimor Komunal i Graçanicës (PZHK), siguron një kornizë afatgjate të zhvillimit të Komunës dhe qytetit, duke përcaktuar qëllimet afatgjate të zhvillimit dhe duke identifikuar prioritetet strategjike. Kjo kornizë duhet të sigurojë

- Zhvillimi ekonomik
- Infrastruktur teknike
- Infrastruktur publike dhe sociale
- Infrastruktur publike dhe sociale
- Ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, resurseve natyrore dhe trashëgimia kulturore
- Vendbanimet dhe banimi

Plani Zhvillimor Komunal i Graçanicës (PZHKG), si plan shumë-sektorial i përcakton qëllimet afatgjate ekonomike, sociale dhe hapësinore të Komunës për periudhën 2022-2031, në harmoni me Planin Hapësinor të Kosovës. Plani Zhvillimor Komunal është dokument strategjik, që përcjell një vizion të qartë për të cilin është arritur përputhja dhe angazhimi i të gjitha palëve të interesit, të specifikuar më tej përmes qëllimeve dhe drejtimeve strategjike. Duke qenë në rolin e harmonizuesit dhe udhërrëfyesit të zhvillimeve të ardhshme në Graçanicës, në sfera të ndryshme të orientuara kah aktivitetet, PZHK-ja ofron mundësinë për të marrë vendime në lidhje me përdorimin e ardhshëm të hapësirës, përcaktimin e regjimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të tij, si dhe aktivitetëve socio - ekonomike dhe mjedisore në territorin e Komunës së Skënderajit. Rëndësia e veçantë e PZHK-së, duke e pasur parasysh qasjen integruese përgjatë procesit të hartimit dhe karakterin shumë-sektorial, qëndron në zhvillimin e harmonizuar të mbështetur në potenciale të arritshme të Graçanicës.

Procesi i hartimit të PZHK-së po ashtu kontribuon në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative në fushën e planifikimit strategjik hapësinor, duke marrë në konsideratë faktin se ky është plani i parë hapësinor për që hartohet me kapacitetet vetanake komunale.

Në procesin e planifikimit rol të rëndësishëm paraqet Vlerësimi Strategjik në Mjedis (VSM), si një proces obligues dhe përcjellës i hartimit të PZHK, me qëllim të vlerësimit të ndikimeve potenciale mjedisore të këtij plani si dhe të përmirësimit të tij, duke sugjeruar objektiva apo strategji të reja apo duke i rishikuar ato ekzistuese. Për PZHK të Skënderajit është zhvilluar procesi i VSM që në

fazat fillestare të saj, duke u integruar tërësisht në procesin e hartimit, si dhe duke e ngritur cilësinë e procesit dhe të dokumentit, të shoqëruar edhe me raportin e VSM-se.

19.1 Pse është i nevojshëm Vlerësim Strategjik Mjedisor

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim njerëzorë dhe ekonomik që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të “parandalimit” sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM).

Procesi i VSM-se është një detyrim ligjor për politikat, planet apo programet. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive

19.2 Qëllimet dhe objektivat zhvillimore

Përcaktimi i qëllimeve për fusha përkatëse paraqet hapin e mëtejshëm dhe më specifik drejt arritjes së vizionit, gjithmonë duke i pasur parasysh çështjet e identifikuar, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet e mundshme në dispozicion. Për secilin qëllim janë përcaktuar edhe objektivat përkatëse, si elemente më specifike, të matshme dhe të arritshme, në mënyrë që të jepet një kornizë më konkrete për zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal. Parimet e përgjithshme të zhvillimit mundësojnë një kornizë udhëzimesh të gjera të cilat burojnë nga dokumente të rëndësishme të planifikimit dhe zhvillimit në nivelin lokal – kosovar, evropian dhe universal botëror.

Objektiva Përgjithshme	Objektivat specifike
ZHVLLIMI EKONOMIK	<p>O1.1. Përmirësimi i ekonomisë përmes zhvillimit ekonomik, bujqësisë dhe turizmit; O1.2. Nxitja e prodhimit bujqësor të qëndrueshëm;</p> <p>O1.3. Sigurimi i tregut dhe aksesit për vendosjen e produktit; O1.4. Ngritja e vetëdijes për një bujqësi të qëndrueshme; O1.5. Nxitja dhe hapja e bizneseve familjare;</p> <p>O1.6. Inkurajimi i punësimit;</p> <p>O1.7. Zhvillimi dhe promovimi i turizmit lokal (kulturor, fetar, rural, sportiv dhe rekreativ);</p> <p>O1.8. Nxitja dhe zhvillimi i biznesit;</p> <p>O1.9. Përfshirja e grave në bujqësi; O1.10. Ruajtja e pyjeve</p>
INFRASTRUKTURA TEKNIKE	<p>O1.1. Mbulueshmëria e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në tërë territorin e komunës;</p> <p>O1.2. Përmirësimi i rrjetit dhe furnizimit me energji elektrike. Mbulimi i</p>
	<p>rrjeteve të telekomunikacionit;</p> <p>O1.3. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta; O1.4. Përmirësimi i trafikut në Komunën e Graçanicës;</p> <p>O1.5. Reduktimi i ngecjeve në trafik në qendër të Graçanicës;</p> <p>O1.6. Përmirësimi i trafikut të këmbësorëve dhe biçikletave, si dhe hapësirave publike;</p> <p>O1.7. Formimi i korridoreve të gjelbra në komunë; O1.8. Përmirësimi i rrjetit rrugor;</p> <p>O1.9. Përmirësimi i transportit publik në komunën e Graçanicës.</p>
INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	<p>O1.1. Përmirësimi i shërbimeve komunale;</p>

INFRASTRUKTURA PUBLIKE SOCIALE DHE	<p>O1.2. Zgjerimi i kapaciteteve akomoduese dhe ngritja në një nivel më të lartë të ofrimit të shërbimeve në fushën e shëndetësisë, arsimit, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe rekreacionit;</p> <p>O1.3. Ngritja e kapaciteteve në fushën e shëndetësisë, arsimit, shërbimit sociale, kulturës, sportit dhe rekreacionit;</p> <p>O1.4. Ofrimi i shërbimeve adekuate dhe cilësore.</p>
MJEDISI, RESURSET NATYRORE DHE TRASHËGIMIA KULTURORE	<p>O1.1. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe resurseve natyrore;</p> <p>O1.2. Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndikimet kimike (mjeteve agroteknike); O1.3. Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje;</p> <p>O1.4. Parandalimi i prerjeve të paligjshme dhe pyllëzimi i tokave të zhveshura; O1.5. Rritja e ndërgjegjësimit mjedisor;</p> <p>O1.6. Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë;</p> <p>O1.7. Përmirësimi i cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës duke trajtuar mbeturinat dhe deponitë ilegale;</p> <p>O1.8. Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore;</p> <p>O1.9. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore (arkitektonike, arkeologjike, peizazheve kulturore, trashëgimisë shpirtërore);</p> <p>O1.10. Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore (materiale dhe jo- materiale);</p> <p>O1.11. Sigurimi i investimeve të fokusuara dhe të përqendruara në atraksionet</p>
	<p>më të rëndësishme kulturore dhe turistike;</p> <p>O1.12. Zvogëlimi i rrezikut dhe përmirësimi i menaxhimit të ndikimeve negative në mjedis dhe trashëgiminë kulturore të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe aktivitetet njerëzore;</p> <p>O1.13. Ngritja e vetëdijes dhe ngritja e kapaciteteve për trashëgiminë kulturore;</p> <p>O1.14. Reduktimi i ndikimit negativ në mjedis në zonat e prirura ndaj fatkeqësive natyrore.</p>
VENDBANIMET DHE BANIMI	<p>O1.1. Përmirësimi i standardit të jetësës së banorëve duke planifikuar vendbanime të rregulluara dhe kapacitete për banim;</p>
	<p>O1.2. Krijimi dhe trajtimi i vendbanimeve në përputhje me ligjet përkatëse; O1.3. Zgjerimi i kapaciteteve të banimit përmes ndërtimit të banesave kolektive dhe individuale.</p>

Tabela 6. *Objktivat e përgjithshme dhe Specifike të PZHK-se*

Qëllimet afatgjata	Qëllimet specifike:
Ndërtim i një infrastrukture të integruar me shërbime efikase për qytetarët	<p>Ndërtimi i një sistemi të transportit efikas, të sigurt dhe të përshtatshëm, me qasje të lehta duke mbrojtur natyrën dhe peizazhin dhe duke plotësuar nevojat e banorëve.</p> <p>Ndërtimi i sistemit të burimeve të ujit të Graçanicës</p> <p>Ndërtimi i një sistemi të integruar të furnizimit me ujë për tërë qytetin e Skënderajt</p> <p>Përparimi dhe ndërtimi i sistemit të ri të ndarë të kanalizimit fekal dhe atij atmosferik</p> <p>Ndërtimi i nënstacionit për trajtimin e ujërave të zeza në rajonin e Graçanicës</p> <p>Kalimi nga rrjeti i furnizimit me energji të mjaftueshme për qytetet dhe biznest</p> <p>Zgjerimi i rrjetit dhe integrimi i telekomunikimeve në Graçanicës dhe nëpër zonat rurale</p>
Industri e gjelbër bashkëkohore - agroindustri, blegtori, industri shërbyese, ndërtimore, etj.	<p>Shfrytëzimi i resurseve natyrore e potencialit local në bujqësi, blegtori dhe shërbime.</p> <p>Prodhimi në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Rritja dhe riaktivizimi i tokave ekzistuese të bujqësisë.</p> <p>Krijimi e një qendre aftësimi - shkollë e mesme profesionale, me hapësira për hulumtim, seminare dhe kurse për grupe të ndryshme - aftësim profesional dhe trajnime.</p> <p>Nxitja dhe përkrahja e bujqësisë, blegtorisë dhe industrisë ekologjike me arritjen e njohurive përkatëse.</p> <p>Ndërtimi i objekteve për grumbullimin e prodhimeve bujqësore</p> <p>Ndërtimi i objekteve të përbashkëta për prodhimin e produkteve</p>
	<p>specifike dhe masat për agrikulturë.</p> <p>Ndërtimi i objekteve për prodhime blegtorale.</p> <p>Ngritja e tregut dhe marketingut për prodhimet rajonale.</p>
Arritja e zhvillimit kompakt	<p>Përcaktimi i tokës së ndërtuar</p> <p>Definimi i qendrës</p> <p>Rritja e dendësisë banimore</p> <p>Qasja e lehtë në shërbimet sociale dhe infrastrukurore</p> <p>Rigjenerimi i hapësirave banimore, vecanërisht ato të qendrës së qytetit</p> <p>Rigjenerimi i hapësirave industrial</p> <p>Mbrojtja e hapësirave të gjelbra dhe tokës bujqësore</p>
Arritja e zhvillimit social të balancuar me mundësi të barabarta të qasjes në shërbime për të gjithë	<p>Sigurimi i hapësirave shkollore në bazë të funksionit dhe hierarkisë së tyre</p> <p>Sigurimi i hapësirave shëndetësore në bazë të funksionit dhe hierarkisë së tyre</p> <p>Sigurimi i hapësirave për sport dhe rekreacion sipas funksionit dhe hierarkisë</p> <p>Sigurim i hapësirave për kulturë sipas funksionit dhe hierarkisë</p> <p>Sigurimi i hapësirave për qendra komunitare në qendrat lokale</p>
Zhvillim i qëndrueshëm hapësinor, në mjedis të gjelbër natyror duke mbrojtur resurset - trashëgiminë natyrore dhe kulturore të qytetit	<p>Kufizimi i zgjerimit të qytetit dhe sigurimi se Graçanicës është hapësirë tërheqëse për të jetuar ku mund të jetohej mirë</p> <p>Minimizimi i ndikimeve të rrezikshme të fatkeqësive elementare në qytet.</p> <p>Përmirësimi i kualitetit të hapësirave të gjelbra</p> <p>Mbrojtja e llojllojshmërisë së peizazheve natyrore</p> <p>Minimizimi i ndikimeve të dëmshme të veprimeve të njeriut në mjedis</p>

<p>Përkrahja e tregut me zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme NVM</p>	<p>Ndërtimi i agjensisë lokale për hulumtim dhe menaxhim të lokacioneve. Sigurimi i hapësirave të përshtatshme për zhvillim ekonomik. Zhvillimi i zonave për biznes dhe atyre industriale me infrastrukturë të përshtatshme, me furnizim vetanak me energji ripërtrirëse. Trajnime për zeje dhe profesione të ndryshme, seminare dhe kurse për zhvillim ekonomik dhe njohuri marketingu. Implementimi i një “inkubatori të biznesit – parku teknologjik” me infrastrukturë të përbashkët dhe me qira të ulëta.</p>
<p>Turizëm rekreativ e kulturor – gërshetim i natyrës dhe historisë</p>	<p>Krijimi i koncepteve dhe ngritja e infrastrukturës për turizëm e rekreacion. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i zonave me potencial turistik rekreativ e kulturor Krijimi i një bordi lokal të menaxhimit të turizmit Krijimi i hapësirave adekuate për turizëm. Ndërtimi i njësive të akomodimit dhe qendrës informuese turistike. Seminare dhe kurse për ngritjen e kapaciteteve të stafit Krijimi i një sinergjie në mes turizmit, agrikulturës dhe ndërmarrjeve te vogla. Zhvillimi dhe zbatimi i veprimeve për përmirësimin e peizazhit të qytetit dhe ruajtjen peizazheve natyrore.</p>

Tabela 7. Qellimet afatëgjata dhe qellimet Specifike të PZHK-se

20.Struktura e Raportit Përfundimtar të VSM-së

Raporti përfundimtar do të jetë i ndarë në kapituj, kështu që secili kapitull do të përmbaj në vete materialin i cili në mënyrë të qartë dhe specifike ka shtjellime dhe sqarime lidhur me VSM. **Kapitulli I^ë**, hyrje, profili i komunal, të dhënat e përgjithshme, historia e zhvillimit, pozita, karakteristikat gjeografike dhe klima, klima, demografia, zhvillimi demografik, dendësia e popullsisë, shtimi natyror i popullsisë , baza ligjore për hartimin e pzhk-së, dokumentet e konsultuara me rëndësi për planifikimin hapësinor, vizioni i pzhk-se, qëllimet dhe objektivat zhvillimore, parimet e përgjithshme

Kapitulli II^{të}, legjislacioni mjedisor dhe institucionet, ligji për mbrojtjen e mjedisit , ligji për planifikim hapësinor, ligji për vlerësimin e ndikimit ne mjedis, ligji për vlerësimin strategjik mjedisor, ligji për vetëqeverisjen lokale, konventat ndërkombëtare mjedisore, MMPHI – detyrat dhe përgjegjësit, vlerësimi i shpenzimeve të dëmtimit mjedisor,

Kapitulli III^{të}, përfshinë ne vete Direktivat e BE-se, Informimin e publikut ,pjesëmarrjen ne vendimmarrje,

Kapitulli IV^{të} , direktivat e BE-s, direktiva e BE-së, VSM –se, direktivat e tjera të BE-së, konventa Århus, konventa ESPOO dhe protokolli i Kievit

Kapitulli V^{të}, mjedisi, gjendja e mjedisit, ndotësit kolektivë, ndotja e ujit, ndotja e ajrit dhe e tokës, deponitë ilegale, ndotja nga zhurma, përmbytjet , tërmetet, transporti i mallrave të rrezikshme, zjarri, erozioni, asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike, trashëgimia arkitekturore, lumenjtë në komunë, zonë e posaçme e mbrojtur për shpendët në Radevë, vendbanimet, banimi

Kapitulli i VI^{të}, Plani zhvillimor komunal Qëllimi dhe Objektivat e PZHK-se, Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal, Pse është i nevojshëm Vlerësim Strategjik Mjedisor,, Qëllimet dhe objektivat zhvillimore

Kapitulli i VII^{të} , kriteret e zonimit të orientuara nga mbrojtja e mjedisit dhe kohezionit social lumenjtë dhe përrenjtë, shtigjet piktoreske, pjesët arkeologjike, masat për parandalimin e dëmtimit të ndikimeve të mjedisit, reduktimi i ndotjes akustike, mbledhja dhe hedhja e ujit, ruajtja e energjisë, masat për parandalimin ndikimin negative social, dispozitat në lidhje me bashkëpunimin, dispozitat mbi rendin kronologjik ose fazat e zbatimit, elementet dhe udhëzimet për hulumtime të mëtutjeshme, gjelbërimi, krijimi dhe sigurimi i hapësirave publike me cilësi të lartë, një balance mes natyrës dhe traditës.

Kapitulli i VIII^{të} – prioritetet zhvillimore strategjike të PZHK-se dhe fushat përkatëse, koncepti i zhvillimit hapësinor, skenarët e propozuar, skenari i integruar-koncepti i zhvillimit, zhvillimi ekonomik sipas sektorëve, ekonomia ,blegtoria, pylltaria, infrastruktura teknike, energjetika, telekomunikacioni, grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave, infrastruktura e transportit dhe transporti publik, infrastruktura rrugore, infrastruktura hekurudhore, transporti ajror, transporti publik, hapësirat publike dhe të gjelbër

Kapitulli i IX^{të} Prioritet zhvillimore dhe strategjike të PZHK-se për fushat përkatëse.

Ne **Kapitullin e X^{të}** Analizimi i plotë i Ndikimit në mjedis

Ne **Kapitullin e XI^{të}** Monitorim,,

Kapitulli XII , Veprimet e sugjeruara nga VSM-ja

Kapitulli XIII Përfundimet.

Kapitulli XIV Literatura - Reference

Mbi bazën e informacionit mbi situatën aktuale mjedisore, ndikimet eventuale të PZHK-se në shëndetin e njeriut dhe elementet e mjedisit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe planet tjera komunale, në të propozohen masa për zbutjen e çdo ndikimi negativ në cilësinë e mjedisit nga zbatimi i PZHK-së.

Do të vlerësohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alternativat e zhvillimeve të PZHK-se -së, me objektiv që të përmirësohet cilësia e jetës së qytetarëve të komunës që banoje aktualisht dhe që do të akomodohen në të ardhmen. Mbi bazën e vlerësimit analitik të cilësisë së elementeve të mjedisit si ajrit, ujërave sipërfaqësore, dhe nëntokësore, mbetjeve të ngurta, zhurmave, sipërfaqeve të gjelbra, në zonat e ndryshme të komunës të lartë cekuar, do të bëhen propozime për masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike, sipas karakteristikave dhe mundësive që lejohen për ndërhyrje për tu konsideruar nga ekipi i hartimit të PZHK-së si dhe ekspertet e raportit të VSM-se. Në përgjithësi masat zbutëse dhe kufizuese/ndaluese do të synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me

KAPITULLI VII

21. VSM - VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PZHK-së

PZHk është zhvilluar duke u bazuar në principet e mëposhtme. Ato janë principe të përgjithshme që duhet të ndërmerren nga PZHk-ja duke u ngritur nga korniza legjislative e një niveli më të lartë dhe Planin Hapësinor të Kosovës (zhvillim i qëndrueshëm dhe kohezion social).

Graquanica si shumica e qyteteve të tjera përballen me një sërë problemesh mjedisore, si psh. degradim i madhë i mjedisit cilësi e dobët e ajrit, nivel i lartë i trafikut, nivel i lartë i zhurmës së ambientit, toka të braktisura, emisione të gazrave, shtrirje të gjerë urbane, probleme të mëdha me mos trajtimin e mbeturinave, mungesa e infrastrukturës në përgjithësi etj. Këto probleme lidhen me një zhvillim urban që nuk është i orientuar drejt zhvillimit për një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. Principet e përgjithshme për zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit ofrojnë një kornizë direktivash të cilat vijnë nga një planifikim i rëndësishëm dhe dokumente zhvillimore në nivelin vendor, Evropian, dhe botëror: Ligjet dhe udhëzimet administrative në Planifikimin Hapësinor dhe Planin Hapësinor të Kosovës NR. 04/L-174; Principet udhëzuese për zhvillim të qëndrueshëm BE (nga strategjia tematike për direktivat mjedisore urbane për qytetet e së nesërme) Principet për zhvillim të qëndrueshëm – Agjenda 21

Për të kundërshtuar aspektet negative të listuara më lartë, janë listuar më poshtë disa principe të rëndësishme për Planin Zhvillimor Komunal

21.1 Kriteret e zonimit të orientuara nga mbrojtja e mjedisit dhe kohezionit social

Përcaktimi i hapësirave të caktuara duhet të përmbushë kërkesat e mbrojtjes së mjedisit, duke ngritur cilësinë e jetës dhe shëndetin publik në këtë zonë, dhe përdorimin racional të burimeve natyrore (psh: hapësirat për banim, sport dhe argëtim nuk mund të jenë pranë kapaciteteve industriale; hapësirat për banim dhe për të gjitha qëllimet e tjera, përveç agrikulturës, nuk mund të jenë në kategoritë e tokave bujqësore I deri IV, etj.).

Gama e efekteve të mundshme të mjedisit në konsiderim ka qenë e informuar fillimisht nga Direktiva e VSM-së. Aneksi i Direktivës së VSM-së kërkon që vlerësimi të përfshijë informacione në “efektet e rëndësishme e të mundshme të mjedisit, duke përfshirë çështjet sikur: biodiversiteti; popullata; shëndeti i njeriut; bota bimore; bota shtazore; drithëra; uji; ajri, toka; faktorët klimatikë; pasuritë materiale; trashëgimia kulturore, përfshirë edhe trashëgiminë arkeologjike dhe arkitektonike; peizazhi; dhe marrëdhëniet e brendshme ndërmjet çështjeve të lartpërmendura”. Në mungesë të drejtimit të detajuar në përmbajtjen e tyre, një numër i këtyre kategorive mjedisore (p.sh.: popullsia, shëndeti i njeriut dhe pasuritë materiale) mund t’i nënshtrohen interpretimeve të

ndryshme. Në kuadër të këtij raporti :

-“*popullata*” përfshinë të dhënat mbi demografinë dhe çështjet kryesore sociale dhe socioekonomike duke përfshirë çështjet e çasjes;

-“*shëndeti i njeriut*” përfshinë të dhëna mbi mortalitetin, sëmundjet dhe mirëqenien e njeriut;

-“*asete materiale*” përfshijnë të dhënat mbi menaxhimin e mbeturinave

Përdorimi i tokës nuk është identifikuar në listën e 12 temave të VSM-së; megjithatë për qëllimet e këtij vlerësimi dhe në veçanti duke pasur parasysh se këto janë vlerësimet e strategjisë, objektivat e para të të cilave përfshijnë përcaktimin e vendndodhjes së zhvillimit, është përshkruar në temën e tokës.

Elementet e Përfshira në VSM	Kategoritë e përdorura gjatë vlerësimit Strategjik Mjedisor
Popullsia	Popullsia (numri i popullsisë, përfshirë efektet socio-ekonomike dhe qasja)
Shëndetësia e popullsisë	Shëndetësia e popullsisë
Toka	Toka(përfshirë shfrytëzimin e tokës, zona të rëndësishme geologjike, ndotja e tokës, shfrytëzimi i saj).
Uji	Burimi dhe cilësia e ujit (përfshirë ujërat e freskët sipërfaqësor dhe ujërat nëntokësor, lumenjet , erozioni)
Ajri	Cilësia e ajrit, monitorimi dhe raportimi i cilesise se ajrit
Faktorët klimatikë	Ndryshim i klimës (përfshirë emetimet e gazrave serrë, efektet e parashikuara nga ndryshimi i klimës sikur: përmytjet dhe aftësitë për t’u përshtatur- adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike
Mbeturinat	Menaxhimi i qendrueshem i mbeturinave
Ujërat e zeza	Trejtimi i ujerave te zeza
Trashëgimia natyrore dhe trashëgimia kulturore,	Trashëgimia natyrore (monumentet e natyres si trashëgimia kulturore kulturore (përfshirë trashëgiminë arkologjike dhe arkitektonike)
Peizazhi	Peizazhi dhe resurset natyrore
Energjia	Furnizimi me energji elektrike
Bujqesia	Menaxhimi i tokave dhe shfrytezimi i tyre
Biodiversiteti, bota bimore dhe bota shtazore	Ruajtja e biodiversitetit dhe natyrës(që përfshinë botën bimore dhe shtazore, dhe funksionimi i ekosistemeve)

Tabela 8. Elemntet e përfshira në VSM

Përforcimi i aksit kryesor urban për rolin e kapitalit

Qëllimi kryesorë është të përforcohet roli funksional dhe figura urbane e qendrës së qytetit me organizimin e një aksi të forte urban zhvilluar përgjatë linjës së rrugëve lokale dhe regjionale .Përmirësimi i infrastrukturës teknike duke, përmirësimi i trafikut, shtigje për këmbësor, formimi i kooridoreve të gjelbra, përmirësimi i transportit publik, përmirësimi i rrjetit rrugor, kualitet i ajrit me mirësi monitorimi i cilësisë online.

Përgjatë aksit, një sistem efikas ndër-modal duhet të organizohet për të siguruar qasjen për në qendrën e Qytetit prej kontekstit të gjerë kombëtar/regjional Lidhjet me autostradë dhe me rrugët unazore; Krijimi i një sistemi tranzit regjional/urban përmes përmirësimit të rrugëve ekzistuese, duke lidhur pjesë të ndryshme të zonave urbane, zonës “trekëndëshe” (EDT), duke përfshirë rrugët regjionale dhe regjionale.

shkurtesat: Periudha e “shkurtë” (SH) përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e “mesme” (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet; Periudha e

“gjatë” (GJ) përcaktohet mbi 10 vjet.

Bidiveziteti flora dhe fauna			Popullsia dhe shëndeti			Toka dhe gjeologjia			Cilësia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshi met Klimatik e			Asetet material dhe Energjia			Trasehege mia natyrore			Peizazhi		
S	M	GJ	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	L	SH	M	G	S	M	GJ
0	+	+	+	+	+	-	-	-	+	+	+	0	+	+	?	?	+	0	0	+	0	0	0	0	+	+

Komentimi

Krijimi i një aksi urban të fortë me sistem të transportit efikas ndër-modal në mes polaritetëve të ndryshme urbane dhe “trekëndëshit” (EDT) dhe prezenca e rritur e funksioneve atraktive në nyjet e sistemit, është supozuar se do të paraqitet në fazat e mesme dhe afatgjate. Rezultatet pozitive shqetësojnë popullsinë dhe cilësinë e jetës për përmirësimin e funksioneve rezidenciale dhe plotësuese (tregu dhe atraksionet), kualiteti dhe përshkimi i hapësirave publike, transporti publik, ashtu edhe ndërtimi i një kualiteti të ri të peizazhit urban, një lëvizje e qytetareve me një mobilitet të qëndrueshëm për të gjithë qytetaret e komunës . Vendosja e funksioneve të reja terciare dhe tërheqja e investitorëve të huaj do të inkurajojë përdorimin e transportit urban, me efekte pozitive në cilësinë e ajrit dhe reduktimin e emetimeve. Këto efekte pozitive do të theksohen në afat të gjatë kohor me kompletimin e aksit. Ruajtja e korridoreve të gjelbërta mund të ketë efekt pozitiv në biodiversitetin në zonat urbane, përdërisa rehabilitimi dhe fortësimi i rrjetit teknologjik do të ketë ndikim pozitiv në cilësinë e ujit, efekte negative në shfrytëzimin e tokës bujqesore dhe ndërtimet jo formale.

Më pak të besueshme janë efektet në peizazhin urban, për shkak të llojshmërisë së ndërhyrjeve të propozuara dhe nevojës për të vlerësuar vendndodhjen e tyre.

Një komunë e këndshme për të gjithë qytetarët

PZHKG-ja është e bazuar në si në vijim:

- Përmirësimi i përhapur “themelor” i cilësisë urbane dhe e pajisjeve dhe hapësirave publike;
- Adaptim në standardet Evropiane të rrugëve, me ndërtim të rrugëve të këmbësorëve dhe biçikletave si dhe parkingjeve për vetura;
- Rritje të rrjetit teknologjik;
- Rritje e pjesërishme e vendbanimeve, të vendosura në atë mënyrë që të rritet dhe të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore dhe mbështetur gjithmonë nga zhvillimi i infrastrukturës, hapësirat publike dhe atraktive, lëvizshmëri të qëndrueshme, rrjetet teknologjike.

Shkurtesat: Periudha e “shkurtë” (SH), përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e “mesme” (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet; Periudha e “gjatë” (GJ) përcaktohet mbi 10 vjet.

Bidiveziteti flora dhe fauna			Popullsia dhe shendet			Toka dhe gjeologjia			Cilsia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet Klimatike			Asetet material dhe Energjia			Trasehegimia natyrore			Peizazhi		
S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	GJ	S	M	G	S	M	G	S	M	G
0	+	+	+	+	+	-	-	-	+	+	+	?	+	+	?	?	+	0	0	+	0	0	0	+	+	+

Koment (përmirësuar)

Zhvillimi i infrastrukturës rrugore, sipas standarteve të BE-se, ndërtimi i shtigjeve dhe gjelbërimi i hapësirave publike si dhe njëkohësisht ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe zgjerimi i vendbanimeve konform PZHK-se.

Shpërndarja selektive e banimit të ri do të gjenerojë përfitime, edhe në ato me afat të mesëm dhe afat të gjatë, drejt qasjes në banesa adekuate dhe komforte. Vështirë për t’u parashikuar janë efektet mbi biodiversitetin, përderisa aty do të ketë një rritje të konsumimit të tokës, dhe do të efekt në shfrytëzimin e hapësirave të gjelbra, ruajtja e cilësisë së ajrit.

Infrastrukturat teknike, publike dhe sociale duke u fokusuar në menaxhimin e mbeturinave do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e ujit (ujin e sipërfaqësor dhe nëntokësor), ajrit dhe ruajtjen e florës dhe faunës . Ndërhyrjet në transportin publik dhe atë të këmbësorëve dhe të rrjetit të ciklit do të promovojë përdorimin e mobilitetit të qëndrueshëm, me efekte pozitive në cilësinë e ajrit dhe në reduktimin e emetimeve, e cila gjithsesi do të kompensohet nga emetimet e rritura në atmosferë (për ngrohje dhe ftohje) prej popullsisë së re të vendosur aty. Implementimi i vendbanimeve të reja do të rezultojë me rritjen e numrit të banoreve si dhe ndikimi në prodhimin e mbeturinave dhe konsumimit të burimeve energjetike, të cilat mund të zbuten me përdorimin proceseve të ndërtimit me kursim të energjisë dhe parandalim të gjenerimit të mbeturinave. Më pak të besueshme janë efektet në peizazhin urban, për shkak të llojllojshmërisë së ndërhyrjeve të propozuara dhe nevojës për të vlerësuar vendndodhjen e tyre.

Skenari i Integruar-Koncepti i Zhvillimit

Zhvillimi i një urbanizmi policentrik

Qëllimi kryesorë është të sigurohen mundësitë për një zgjerim urbanistik të balancuar dhe të qëndrueshëm, duke ju shmangur plandosjes së pakontrolluar dhe jokonsekuente, përderisa sigurohen hapësirat atraktive të nevojshme,

objektet dhe zonat e aktiviteteve për të formuar lagje të integruara dhe të banueshme.

Banimi “multipolar” ose “policentrik” është investiguar për të siguruar nivel të lartë të pajisjeve dhe prezencë të

shpërndarë të aktiviteteve në “zonat urbane” më të mëdha, duke reduktuar kërkesën për mobilitet. Kjo padyshim se

duhet të përmirësojë cilësinë aktuale urbane të vendbanimeve ekzistuese, e cila zakonisht është e dobët.

Në anën tjetër ruajtja e tokës bujqësore dhe karakteristikave të peizazhit, do të rrisë cilësinë mjedisore të vendbanimeve të reja.

shkurtesat: Periudha e “shkurtë” (SH), përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e “mesme” (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet; Periudha e “gjatë”

(GJ) përcaktohet mbi 10 vjet.

Bidiveziteti i flora dhe fauna			Popullsia dhe shendeti			Toka dhe gjeologjia			Cilsia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet Klimatike			Asetet material dhe Energjia			Trasehegimia natyrore			Peisazhi		
S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	L	S	M	G	S	M	G	S	M	Gj	S	M	Gj
0	?	?	0	+	+	0	-	-	++	+	+	0	+	+	?	?	+	?	?	+	0	+	+	0	+	++

Komenti;

Duke i forcuar, konsoliduar dhe përmirësuar vendbanimet ekzistuese policentrike mund të përcaktoj efekte pozitive mbi cilësinë e jetës në këto qendra, në zona bujqësore dhe të peizazhit. Afërsia e popullatës me pajisje kontribon në reduktimin e kërkesave për mobilitet, me efekte pozitive në cilësinë e ajrit dhe në reduktimin e ndotjes. Ruajtja e njohjes së qendrave të ndryshme do të ketë ndikim pozitiv në ruajtjen e vlerave kulturore dhe identitetin e komuniteteve lokale. Jo të sigurta janë ende efektet në ujë, konsumimi i energjisë dhe prodhimi i mbeturinave, sikur do të jetë mbi PZHKG-en të definojnë zonat e reja urbanistike dhe zonat e rigjeneruara në qytete më të vogla.

Vlerat kulturore dhe natyrore: ruajtja e identitetit, përmirësimi dhe vlerësimi

Trashëgimia kulturore Strategjia integron qasjen ndaj trashëgimisë kulturore, që bën përzierjen e ruajtjes dhe vlerësimit. Vlerësimi korrekt është çelësi që mund të ketë një vend për të shfaqur panoramën më të mbushur dhe më kompetitive të kulturës . Veprimet kryesore të propozuara janë: Udhëzimet për mbrojtjen e tokave bujqësore; Zhvillimi i një katalogu të përditësuar i trashëgimisë kulturore lokale, përfshirë peizazhet kulturore dhe trashëgiminë e paprekur; Trajnimi i njerëzve profesional me kompetenca specifike në ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore; Për qendrën kulturore, definicioni për të dhëna nga analizat historike dhe dokumentacionet nga arkiva.

Trashëgimitë natyrore Ruajtja e karakteristikave natyrore dhe gjysëm-natyrore , pyjeve, liqeneve, lumenjve, parqeve në qytet mund të përbëjnë elementet kyçe për sigurimin e rrjetit ekologjik. Veprimet kryesore të propozuara janë:

- Ruajtja dhe rritja e ujit të mbetur dhe/ose korridoreve të gjelbërta

shkurtesat: Periudha e “shkurtë” (SH), përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e “mesme” (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet;

Periudha e “gjatë” (GJ) përcaktohet mbi 10 vjet.

Bidiveziteti i flora dhe fauna			Popullsia dhe shendeti			Toka dhe gjeologjia			Cilsia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet Klimatike			Asetet material dhe Energjia			Trasehegimia natyrore			Peisazhi		
S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	Gj	S	M	G	Sh	M	G
+	+	+	+	+	+	?	?	?	+	+	+	+	+	+	+	+	+	?	?	+	+	++	+	+	++	+
+	+	+	+	+	+				+	+	+										+		+	+		+

Komentimi

Kjo strategji përfshinë një numër të dobive për komponentët e ndryshme që kemi marrur parasysh.

Nëse nga pikë vështrimi i popullsisë regjenerimi dhe vlerësimi i zonës qendrore ose krijimi i korridoreve të aksesueshme të gjelbërta mund të rrisin cilësinë e kushteve jetësore duke krijuar mjedise komode, me një gamë të gjerë të vendeve komerciale, lokacione zeytare, etj., dhe duke përmirësuar hapësirat publike dhe duke rritur mundësi për rekreacion, në anën tjetër mund të ketë efekte pozitive mbi biodiversitetin, cilësinë e ujit (rrypa thithës të gjelbërt që kontribuojnë në ruajtjen e kurseve të ujit gjithashtu luajnë rol pastrues), cilësinë e ujit (mbrojtjen e pluhurit dhe funksionin e ruajtjes së CO₂).

Efektet pozitive ekonomike mund të paraqiten si lidhje për të rritur tërheqjen e turistike dhe si lidhje për zhvillimin e sektorëve ekonomik kushtuar ekologjisë dhe përdorimit të zonave të gjelbërta.

Mjetet e njohurive të zhvillimit, veprimet dhe rregullat e ruajtjes për promovimin e trashëgimisë kulturore (përfshirë trajnimin) do të kontribuojnë dukshëm në arritjen e vlerave të identitetit të komuniteteve në Kosovë.

Më pak të sigurta janë efektet e tokës, konsumimi i gjeologjisë dhe burimeve, të cilat do të ekzaminohen

në relacion me ndërhyrjet e transformimit përfundimisht të përfshira në plan për regjenerimin dhe vlerësimin e qendrës historike.

Rritja e Modeleve të vendbanimeve rurale për një zhvillim të ri bujqësor

Mirëmbajtja e prezencës njerëzore në zonë, duke përmirësuar kushtet e banimit, zhvillimin e objekteve shërbyese dhe përmirësimi i rrjetit rrugor;

Zhvillimi i bujqësisë dhe pylltarisë multifunksionale (kujdesja për pyllin dhe ripyllëzimin). Lidhur me bujqësinë e re, në kontekstin e afërt me një qytet të madh, kjo do të thotë që nuk është e kufizuar për prodhimin e thjeshtë të lëndëve të para për ushqim, dhe që të integrohet në një kuadër më të gjerë një gamë të

funksioneve dhe pajisjeve të cilat mund t'i përfitojnë të gjithë qytetarët. Ky vizion i bujqësisë multifunksionale po del prej disa vitesh si një referencë kryesore për zhvillimin e ardhshëm të zonave rurale.

shkurtesat: Periudha e "shkurtë" (SH), përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e "mesme" (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet; Periudha e "gjatë" (GJ) përcaktohet mbi 10 vjet.

Bidiveziteti flora dhe fauna			Popullsia dhe shendeti			Toka dhe gjeologjia			Cilsia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet Klimatike			Asetet material dhe Energjia			Trasehegemia natyrore			Peisazhi		
S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G
?	?	?	+	+	+	?	?	?	0	0	0	+	+	+	0	0	+	?	?	?	+	+	+	+	+	+

Komentimi

Riorganizimi i objekteve shërbyese themelore në vendbanimet rurale sic janë shkollat dhe shtëpitë e shendetit, qendra tjera kulturore duke përmirësuar transportin publik, siguri dhe përmirësimin e rrugëve për t'u shërbyer fshatrave dhe zhvillimit të bujqësisë multifunksionale, do të prodhojë efekte të mëdha në cilësinë e jetës dhe do të krijojë më shumë mundësi të të ardhurave për ndërmarrjet bujqësore (bujqësi multifunksionale). Një shpërndarje më e mirë e objekteve shërbyese do të ketë përfitim në kushtet e banorëve dhe do të rrisë mundësinë e të ardhurave në fshatrat rurale.

Në përgjithësi, sjellja e objekteve shërbyese tek banorët dhe përmirësimi i zbatueshmërisë së rrugëve, do të ketë efekt pozitiv në cilësinë e ajrit dhe në reduktimin e ndotjes. Më pak të sigurta janë efektet mbi biodiversitetin, tokën dhe gjeologjinë sikur do të varej nga vendndodhja e ndërhyrjeve individuale.

Efekte pozitive mund të ketë në trashëgiminë kulturore dhe peizazhin, si objektive të strategjisë: të ruhet prezenca e njerëzve në zonat rurale, kështu duke favorizuar ruajtjen e peizazhit tradicional bujqësor.

Përmirësimi i cilësisë mjedisit urbane dhe rural - Qëllimet kryesore përgjithësisht janë:

- Përmirësimi i cilësisë së ujit
- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave
- Rritja e efikasitetit dhe përdorimit të energjisë së rinovueshme;
- Reduktimi i emetimit të gazrave të serrave
- Përmirësimi i ajrit të jashtëm
- Përmirësimi i transportit urban
- Parandalimi dhe reduktimi i zhurmës dhe ruajtja e zonave të qeta;
- Qeverisje lokale më efikase;
- Planifikim dhe konsumim i tokës më efikas;
- Rritje e biodiversitetit dhe hapësirave të gjelbërta;
- Reduktimi i rreziqeve mjedisore.

Prioritetet e propozuara janë:

1. Identifikimi i zonave me faktorë rrezikues (Harta e rreziqeve: erosi, rreziqet seizmike, etj.,) në mënyrë që të

definohen zonat ndërtimore dhe veprimet për të limituar vendbanimet ekzistuese

2. Fortësimi i rrjeteve për monitorim mjedisor;

3. Përforsimi i rrjetit energjetik për nevojat e energjisë;

4. Riorganizimi i sistemit të të humburave;

shkurtesat: Periudha e “shkurtë” (SH), përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e “mesme” (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet; Periudha e

“gjatë” (GJ) përcaktohet mbi 10 vjet.

Biodiveziteti flora dhe fauna			Popullsia dhe shëndeti			Toka dhe gjeologjia			Cilsia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet Klimatike			Asetet material dhe Energjia			Trasehegemia natyrore			Peisazhi		
S	M	G	S	M	G	S	M	Gj	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	GJ	SH	M	G
+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
	+	+		+	+					+	+		+	+					+	+					+	+

Komentimi

Ky plane zhvillimor ofron përfitimet mjedisore më të mëdha në periudhë të shkurtë, të mesme dhe të gjatë kohore (SH- M- GJ).

Definicioni i kufizimeve në zhvillimin e vendbanimeve në hartën e rreziqeve shkon në këtë drejtim, sikurse edhe linjat e veprimeve në lidhje me forcimin e rrjeteve monitoruese, rritja e rrjetit energjetik, në të njëjtën kohë, fillimi i veprimeve për efikasitet më të madh të energjisë dhe për përdorim më të madh të burimeve të rinovueshme, duke synuar drejt ndalimit të varshmërisë së fortë nga përdorimi i linjtitisi dhe duke krijuar kushte për energji alternative. Reduktimi i faktorëve rrezikues dhe i ndotjes mjedisore (ajri, uji, toka, etj.), do të gjenerojë në efekte indirekte mbi përmirësimin e cilësisë jetësore për banorët dhe bizneset, duke krijuar kushte të favorshme për t'i tërhequr investimet e huaja, duke kushtuar vëmendje edhe më të madhe në jetën dhe punën e mjedisit.

Më pak të sigurt janë efektet në peizazh për shkak të ndryshueshmërisë së ndërhyrjes së propozuar dhe nevoja për t'iu qasur vendndodhjes së tyre.

Nxitja e nisjes së ndërmarrjeve të reja

Ky plane fokusohet në perspektiven e të rinjve :nxenes, studentë, hulumtues dhe sipërmarrës të rinjë.

Ideja fokusohet në inkurajimin e të rinjve të fillojnë biznes dhe kështu të arrihet kapital më i madh në treg për të ngjallur ekonominë në tërësi. Universiteti mund të sigurojë një mjedis mbështetës për shpërndarje të dijes që të sigurojë themelin e kompanive produktive dhe fitimprurëse.

Strategjia propozon veprimet primare si më poshtë:

Përcaktimi i lokacioneve të mundshme për zhvillimin e bizneseve

Të ndihmojë shkëmbim me universitetet e huaja, auditimet e nivelit mësimorë me kritika të huaja.

Përcaktimi i strategjive regjionale inovative; Përcaktimi i strategjive të ndërmarrësish regjionale

Studimet para-fizibiliteti në themelimin dhe operimin e hulumtimeve të ndryshme shkencore Studimet para-fizibilitike në kapitalin rrezikues për krijimin e iniciativave për nisjen e ndërmarrjeve të reja Zhvillimin e projekteve pilote duke mbështetur implementimin e veprimeve inovative dhe strategjive regjionale

Nisjen e objekteve shërbyese.

shkurtesat: Periudha e "shkurtë" (SH) përcaktohet < 5 vjet;

Periudha e "mesme" (M) përcaktohet mbi 5 vjet dhe jo më shumë se 10 vjet; Periudha e

"gjatë" (GJ) përcaktohet mbi 10 vjet.

Bdivезite ti flora dhe fauna			Popullsi a dhe shendeti			Toka dhe gjeologjia			Cilsia e ujit dhe burimet			Cilësia e ajrit			Ndryshimet Klimatike			Asetet material dhe Energjia			Trasehegimia natyrore			Peisazhi					
S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G	S	M	G			
h		J	H		J	h		J	H		J	H		J	H		J	H		J	H		J	H		J			
0	0	+	+	+	+	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	?	?	?	0	0	0	?	?	?

Komentimi

Ky plane përfshin aksionet dhe prandaj vlerësimi i efekteve mjedisore të mundshme është vështirë të parashikohen ose të pa aplikueshme (pa bashkëveprim). Është e mundshme të thuhet se efektet mbi popullsi edhe në afat të shkurtë, janë të konsiderueshme në termin e rritjes së mundësive të punësimit, nivelit të edukimit, dhe kryesisht në termin e cilësisë jetësore.

Të paparashikueshme në këtë fazë janë efektet në peizazh dhe në burimet e konsumuara, kushtuar mundësisë së rritjes së sistemit ekonomik. Në lidhje me ndikimet e tjera mjedisore është e mundshme që ato janë shumë të ulëta, në relacion me zhvillimin e aktiviteteve të ngjitura në dijen ekonomike dhe kreativitetin.

22.KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

PZHK kaloi përmes një procesi ndërveprues në të cilin ekspertët dhe stafi komunal zhvilluan tre opsione alternative të zhvillimit. Në këto sesione, pjesëmarrësit punuan në harta që paraqesin situatën aktuale dhe zhvillimet e ardhshme.

22.1 Skenarët e Propozuar

Skenari i trendit

- Zona shumë të mëdha të rrezikuara nga zgjerimi urban;
- Zona shumë të mëdha për zhvillim në tokën e cila nuk është e përshtatshme për ndërtim, apo mbi tokën cilësore bujqësore;
- Shfrytëzimi i tokës, promovimi i shfrytëzimit të përzier në kuadër të një "qasjeje realiste" e cila përmban trendin aktual;
- Nxitje e shfrytëzimit maksimal të rrugëve ekzistuese kryesore dhe tranzit;
- Sa i përket shfrytëzimit të tokës, zhvillimi do të jetë intensiv, dhe do të bëjë të mundur që investimet në transportin publik dhe hapësirën për banim të jenë të realizueshme;
- Kujdes i është kushtuar rritjes së prodhimtarisë dhe konsumit;
- Kujdes i është kushtuar edhe mbrojtjes së mjedisit;
- Shërbimet të orientuara kryesisht përgjatë korridoreve (rrugëve).

Përshkrim i skenarit të zhvillimit sipas trendit

Është propozuar:

- Në bazë të trendeve ekzistuese të zhvillimit, konsiderohet se në të ardhmen vendbanimet duhet të zgjerohen ekskluzivisht në qendër;
- Të vërtetohet mundësia e zvogëlimit të madhësisë së lokalitetit Ulpiana në të ardhmen;
- Kryesisht janë propozuar objekte të banimit individual, me përjashtim të pjesëve të caktuara të vendbanimit ku tashmë ka pjesë të banesave kolektive ose tokë komunale për ndërtimin e banesave sociale;

- Planifikimi dhe ndërtimi i një rruge tranzit që të shmangen ngecjet dhe zhurma në qendër të Graçanicës;
- Ndërtimi i infrastrukturës së re (rrugë, kanalizim, ujësjellës) në pjesë të zgjerimit të vendbanimit.
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve në territorin e komunës së Graçanicës me qëllim të parandalimit të vërshimeve të lumenjve.
- Duke pasur parasysh që në pjesën perëndimore dhe jugore veprimtaria kryesore e fshatit është blegtoria dhe bujqësia, është propozuar që ata të vazhdojnë aktivitetin e tyre dhe t'i zhvillojnë ato aktivitete edhe më tutje;
- Ndërtimi i objekteve bujqësore në Graçanicë, Livaxhë, Lepi, Skullanevë dhe Suhadoll;
- Ndërtimi i tregut të blegtorisë në Llapnasellë;
- Zhvillimi i transportit publik i cili lidh të gjitha vendbanimet;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për pjesën perëndimore të komunës në Batushë i cili është vendbanimi i vetëm që nuk ka sistem të ujësjellësit;
- Rindërtimi i tubacionit ekzistues bujqësor në Graçanicë dhe trajtimi i ujërave të zeza në pjesën jugore të vendbanimit të Graçanicës për shkak të derdhjes së ujërave të zeza;
- Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta ku është e mundur;
- Ndërtimi i lokacioneve të përkohshme për ndërtim dhe deponim të mbeturinave të ngurta;
- Rindërtimi i hekurudhës ekzistuese (Lepi, Llapnasellë, Graçanicë dhe Kishnicë) dhe rihapja e hekurudhës për udhëtarët që të vizitojnë objektet kulturore;
- Ndërtimi i një stacioni riciklimi (të veçantë) të ndarjes së mbetjeve;
- Ndërtimi i varrezës së bagëtive në Gushtericë të Poshtme;
- Ndërtimi i një rezervuari më të madh sedimentues në Kishnicë;
- Zona të veçanta të mbrojtura rreth kishës në Dobratin, Llapnasellë, Gushtericë e Poshtme.



Foto 12 – Punë në grupe te eksperteve gjate përpilimit te skenareve

Shënime për grupin e parë:

- Një skenar trendi është një skenar ku nuk punohet asgjë në aspektin e planifikimit. Megjithatë, ky skenar përmban disa elemente planifikimi që mundësojnë mbrojtjen e tokave bujqësore;
- Përcaktimi i zonës urbane të vendbanimit Marigona, që në të ardhmen synon të zgjerohet;
- Zgjerimi i mëtutjeshëm i vendbanimit Marigona duhet parandaluar në të ardhmen për të mbrojtur tokën bujqësore;
- Gjithashtu, trendi i blerjes së tokës në fshatrat perëndimore nga Aeroporti i Prishtinës mund të jetë rrezik në të ardhmen;
- Krijimi i një bypass-i të ri nga Ministria e Infrastrukturës përmes tokës bujqësore të cilësisë së lartë pa konsultim paraprak me Komunën e Graçanicës në trasenë e rrugës.
- Është iniciuar çështja e konsolidimit /ri-parcelizimit të tokës;
- Pas bisedimeve me ekspertin e VSM-së, është paraqitur ideja që prapë të aktivizohet linja hekurudhore dhe të ndërtohen stacionet pritëse për autobusë dhe hekurudhë dhe të gjithë vizitorëve t'u sigurohen biçikletat për vozitje dhe shijimin e peizazhit të komunës;

- Shtigjet e planifikuara për këmbësorë dhe biçikleta do të ndikojnë në zvogëlimin e emetimit të CO₂;
- Është planifikuar sistemi i ri për menaxhimin e mbeturinave të ngurta;
- Respektimi i shtretërve të lumenjëve dhe sistemet e planifikuara për trajtimin e ujërave të zeza;
- Toka dhe infrastruktura – përqëndrimi i zonave të reja, reduktimi i shfrytëzimit të tokës;
- Kultura dhe ekonomia – ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e zhvillimit ekonomik dhe kulturës;

22.2 Skenari i zhvillimit të përqendruar

- Inkurajimi i rehabilitimit dhe /apo ripërdorimit të strukturave ekzistuese;
- Ruajtja e kontekstit rural;
- Ruajtja e zonave rurale, zhvillimi dhe nxitja e turizmit rural;
- Rikonstruksioni i hekurudhës ekzistuese (krijimi i korridoreve të gjelbra);
- Zonat për zgjerimin e vendbanimeve, mbrojtjen nga shkatërrimi i tokës së cilësisë së lartë;
- Zonat e përcaktuara të vendbanimeve, planifikimi i kujdesshëm, pa zgjerim të madh;
- Zhvillimi i turizmit (Etno Hotel-sinergji me trashëgiminë kulturore);
- Promovimi i prodhimit të ushqimit organik;
- Rrugë tranzit rreth Graçanicës (duke marrë parasysh rrezikun e mundshëm në zonën urbane);
- Theksi në bujqësinë ekstensive, ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore;
- Ndërtimi i një brezi të gjelbër dhe shtigjeve për biçikleta përgjatë korridoreve rrugore dhe vënia në punë e hekurudhës ekzistuese;

Shënime per grupin e dytë

- Zhvillimi i rrugëve të reja është një rrezik potencial sepse mund të fillojë ndërtimi i objekteve tregtare përgjatë rrugës;

- Asgjë nuk duhet planifikuar në vetë kufijtë e komunës, vetëm në pjesët ku tashmë janë ndërtuar zonat e banimit dhe ato të biznesit;
- Në një ushtrim për marrëdhëniet ndër-sektoriale, anëtarët e grupeve të tjera kanë konsideruar se marrëdhënia mes shfrytëzimit të tokës dhe banorëve nuk është edhe aq negative sa e cilësoi ky grup, por duhet të ishte mesatare.

Raporti në mes të mjedisit dhe burimeve natyrore ndaj infrastrukturës, transportit dhe lëvizshmërisë duhet të jetë negativ.

22.3 Skenari i zhvillimit të decentralizuar

Ky skenar tregon zhvillimin e decentralizuar në tre vendbanime specifike, secila me qendrën e vet.

Karakteristikat e skenarit janë:

- Zhvillimi i decentralizimit dobëson qendrën ekzistuese të qytetit;
- Zhvillimi fokusohet në disa pika të përdorimit efikas të tokës dhe resurseve të tjera;
- Qendra dhe shumica e pjesëve të fshatrave janë të furnizuar me shërbime;
- Pjesë të mëdha të rrafshëve mund të shfrytëzohen për bujqësi;
- Distanca të shkurtra brenda komunës;
- Trafiku ndërurban është zhvendosur jashtë qytetit të Graçanicës;
- Pjesët e largëta të fshatrave nuk janë të zhvilluara.

22.4 Përshkrimi i skenarit të zhvillimit të decentralizimit

Është propozuar:

- Qendër mbetet vendbanimi i Graçanicës (për vendbanimet: Badovc, Sushicë, Kishnicë)
- Nënqendrat:
 - Llapnasellë (për vendbanimet Çagllavicë, Preoc, Uglarë);
 - Gushtericë e Poshtme (për vendbanimet: Dobrotin, Livaxhë, Gushtericë e Epërme);
 - Lepi (për vendbanimet: Skulanevë, Suhadoll, Radevë, Batushë, vendbanimi i ri, Ashani);

- Mbrojtja e tokës bujqësore;
- Krijimi i zgjerimeve të reja në vendbanime në përputhje me tendencën e zhvillimit të vendbanimeve;
- Përdorimi i tokës së mirë komunale për të ndërtuar objekte publike për zhvillimin e komunës;
- Kthimi i tokës në pronësi shoqërore në privatizim, duke mos lejuar që toka dhe objektet t'u jepen bizneseve private në shfrytëzim;
- Ndërtimi i rrugës tranzit rreth Graçanicës, i ndarë nga Hajvalia nga drejtimi i Prishtinës dhe i kthyer në fshatin Kishnicë - drejtimi Gjilan;
- Lidhje e mirë me aeroportin, mirëmbajtje e rrugës ekzistuese;
- Vënia në punë e hekurudhës ekzistuese Graçanicë – Llapnasellë – Lepi – Preoc, e cila mund të shfrytëzohet për qëllime turistike;
- Ndërtimi i një qendre të re të shkollës së mesme;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e të gjitha institucioneve arsimore (objekte kulturore, shkolla fillore, parashkollore dhe kopshte);
- Ndërtimi i spitalit në Graçanicë dhe investimi në mirëmbajtjen e të gjitha objekteve shëndetësore;
- Zhvillimi i sportit, investimi në ndërtimin e objekteve të reja dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe të gjitha terreneve sportive në komunë;
- Ndërtimi i një tregu për plasimin e produkteve;
- Ndërtimi i zonës së inkubatorit të biznesit në zonën drejt Uglarit;
- Ndërtimi i depozitës së sedimentimit në Graçanicë;
- Stacion autobusi;
- Stacioni hekurudhor në Suhadoll (aty ka qenë një stacion hekurudhor);
- Zgjerimi i zonës së mbrojtur rreth lokalitetit arkeologjik të Ulpianës, por me mundësi të vazhdimit të hulumtimit duke respektuara edhe kriteret për zgjerimin e këtyre zona dhe rëndësisë së tyre ;
- Ngushtimi i zonës së mbrojtur të veçantë të Graçanicës;
- Gjelbërimi i mbetjeve dhe krijimi i zonës rekreative;
- Zonë sportive dhe rekreative në periferi të Llapnasellës drejt Livaxhës;
- Krijimi i korridoreve të gjelbra përgjatë rrugëve aty ku është e mundur;

- Krijimi i biznesit përgjatë vendbanimeve ekzistuese për zhvillim ekonomik;
- Vende turistike;
- Pellgu i Radevës.

Shënime për grupin e parë:

- Planifikimi dhe ndërtimi i rrugëve të reja kërkon një vlerësim strategjik mjedisor;
- Impianti i riciklësimit: mbledhja mbeturinave në një vend dhe kryeni klasifikimin;
- Lënia e inkubatorëve më të vegjël të biznesit tek pronarët privatë dhe përdorni tokën komunale (pasi nuk ka shumë) për të krijuar një inkubator biznesi të ri dhe më të madh që do t'u shërbejë të gjithë sipërmarrësve për të forcuar dhe zhvilluar bizneset e tyre;
- Kufizimi i zgjerimit të Graçanicës drejt Sushicës nga të gjitha anët;
- Nëse një inkubator biznesi ndërtohet në periferi të Preocit në drejtim të Uglarit, ekziston rreziku i lartë që të humbasë toka bujqësore (afër Çagllavicës së zhvilluar);
- Për këtë skenar të decentralizuar, është e nevojshme të sigurohet kontrolli i zhvillimit, në mënyrë që ai të kufizohet në një vend;
- A mund të përdoret hekurudha për qëllime turistike?
- Kontrolloni mundësinë e konsolidimit të tokës;
- Merrni parasysh rritjen e popullsisë — sa tokë duhet të planifikohet për vendbanimet e reja;
- Pranë zgjerimit të planifikuar të vendbanimit të Graçanicës në veri ndodhet një gurore dhe toka kryqëzohet me kanale minerale. Për të parandaluar rrëshqitjet, është e nevojshme të bëhet një studim fizibiliteti përpara zgjerimit të vendbanimit;
- Rrugët e reja shkurtojnë distancën dhe kursejnë kohë, por ato varen nga vlerësimi i ndikimit në mjedis;
- Komuna duhet të sigurojë një përqindje të caktuar të hapësirës së gjelbër për çdo parcelë biznesi;
- Një ide e mirë për shfrytëzimin e tokës komunale është tërheqja e investitorëve për të investuar në zhvillimin e komunës;
- T'i kthehet komunës toka shoqërore dhe të menaxhohet nga komuna

Skenari i Integruar-Koncepti i Zhvillimit

Bazuar në skenarët e zhvilluar (skenarë trendi, të koncentruar dhe të decentralizuar), u arrit në përfundim që të mbahet skenari i trendit me disa pjesë nga skenari i koncentruar dhe ai i decentralizuar. Skenari i integruar (propozuar) do të jetë bazë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor në komunë. Skenari i koncentruar përbëhet nga:

Graçanica, qendra kryesore për të gjitha vendbanimet dhe për vendbanimet që gravitojnë në drejtim të Graçanicës, Badovc, Kishnicë dhe Sushicë,

➤ Nën-qendrat:

- Llapnasellë (për vendbanimet Preoc dhe Çagllavicë)
- Gushterica e Poshtme (për vendbanimet Livaxhë, Gushterica e Epërme dhe Dobratin)
- Lepi (për vendbanimet Skullanevë, Suhadoll, Radevë, Batushë).

Bazuar në trendet ekzistuese të zhvillimit, konsiderohet se në të ardhmen vendbanimet do të zgjerohen në mënyrë qendrore (si më parë).

- Zgjerimi i vendbanimit të Graçanicës është në drejtim të vendbanimeve Badovc dhe Sushicë (banime individuale) dhe drejt veriut, ku tashmë është ndërtuar një kompleks i ndërtesave kolektive, do të mbetet vetëm zgjerimi qendror. Në varësi të hapësirës dhe nevojës mund të ndërtohet edhe një godinë tjetër.

Në pjesën veriore, ku tashmë janë vendosur banesat kolektive, është krijuar një kompleks i ri administrativ, i cili do të përpiqet të rregullojë atë pjesë dhe të zgjerojë kapacitetet ndërtimore. Përgjatë rrugës kryesore Prishtinë-Graçanicë-Gjilan, në pjesën qendrore të vendbanimit Graçanicë, ka objekte afariste, trendi i të cilave do të vazhdojë të forcojë zhvillimin ekonomik të banorëve të vendbanimit Graçanicë.

- Zgjerimi i vendbanimit Llapnasellë është i planifikuar në mënyrë qendrore, kryesisht është planifikuar banim individual. Gjithashtu, në Llapnasellë tashmë është ndërtuar një kompleks pallatesh banimi ku është e mundur që në varësi të hapësirës dhe nevojave të parashikohet një objekt tjetër banimi. Në drejtim të veriut vendbanimi bashkohet me vendbanimin Çagllavicë, ndërsa në anën perëndimore bashkohet me vendbanimin Preoc. Është krijuar një zonë biznesi ndërmjet Llapna sellës dhe Çagllavicës, e cila do të mbahet në atë drejtim.

- Planifikohet zgjerim qendror për vendbanimin Çagllavicë, në të cilin është planifikuar banim individual.
- Zgjerim qendror është planifikuar edhe për vendbanimin Preoc, ku është planifikuar vetëm banim individual.

Duhet të parandalohet zgjerimi i mëtejshëm i vendbanimit Marigona në Preoc për të mbrojtur cilësinë e lartë të tokës.

Vendbanimet Gushtericë e poshtme dhe Gushtericë e epërme janë të shtrira në mënyrë qendrore por edhe në vijën e një pjese përgjatë rrugës Lipjan-Gushtericë e Poshtme - Janjevë. Aty janë planifikuar banesa individuale.

Vendbanimet që planifikohet të zgjerohen në qendër dhe që nuk bashkohen me asnjë vendbanim tjetër janë: Lepia, Skullaneva, Batusha, Suhadolli, Ashania, Vendbanimi i ri, Radeva, Livaxha, Dobratini dhe Uglara. Në këto vendbanime është planifikuar vetëm banim individual.

Për zhvillimin e komunës është planifikuar:

- Kthimi në komunë i tokës sociale që është nën shpronësim për menaxhim dhe shfrytëzim, e cila do të jetë me rëndësi të madhe në forcimin e zhvillimit social dhe ekonomik;
- Është ngritur çështja e konsolidimit/riparcelimit të tokës. Të ndalohet riparcelimi i tokës në pjesët ku është përcaktuar mbrojtja e tokës bujqësore;
- Shpronësimi i pasurive të paluajtshme për ndërtimin e objekteve ekonomike, banesore, komunale, shëndetësore, arsimore, kulturore dhe objekte të tjera me interes të përgjithshëm. Nevoja për shpronësim ekziston edhe për ndërtimin e projekteve infrastrukturore, me qëllim ndërtimin e rrugëve të reja apo zgjerimin ekzistues;
- Është e nevojshme të përgatitet një studim/hulumtim i lokalitetit arkeologjik Ulpiana në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Institutin Arkeologjik dhe të shqyrtohet nëse ekziston mundësia për të reduktuar zonën e mbrojtur rreth lokalitetit arkeologjik Ulpianë. Të kërkohet nga institucionet kompetente që të bëjnë një ekzaminim;
- Zgjerimi i vendbanimit është planifikuar të jetë qendror, kryesisht banim individual. Banimi kolektiv ekziston në Graçanicë, Llapnasellë, Gushtericë të Poshtme, Dobratin, Uglarë dhe Suhadoll.

Në varësi të nevojave, planifikohet zgjerimi i banesave kolektive në lokacionet ekzistuese, si dhe në vendbanimet tjera ku ka tokë komunale për ndërtimin e këtij lloji të banesave;

- Zona e biznesit në komunë është formuar përgjatë autostradës Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Lipjan. Zgjerimi i zonës së biznesit është planifikuar vetëm përgjatë rrugës pasi tashmë kjo zonë është formuar;
- Ndërtimi i një objekti më të vogël administrativ/publik në Lepi (poshtë qendrës) për të ofruar shërbime për banorët e asaj pjese të komunës;
- Bypass i ri, qëllimi i të cilit është:
 - Të zvogëlohet bllokimi i trafikut nëpër vendbanimin e Graçanicës,
 - Të formohet një zonë për këmbësorë që do të mbyllet në një periudhë të caktuar kohore, e cila do të përmirësonte cilësinë e jetës sociale dhe do të nxiste zhvillimin e turizmit.
 - Formimi i katroreve me vija.
 - Mbulimi i shtratit të lumit, pjesa qendrore që mund të lidhet me shetitoren.
 - Mbrojtja e manastirit mesjetar të Graçanicës.
 - Rregullimi i rrugëve me një profil të përshtatshëm, sigurimi i shtigjeve për këmbësorë dhe aty ku është e mundur sigurimi i shtigjeve për biçikleta;
 - Ndërtimi i ndriçimit të ri në pjesët ku nuk ekziston, mirëmbajtja e atyre ekzistuese në territorin e gjithë komunës;
 - Shënjimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale në të gjithë territorin e komunës;
 - Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për zgjerimet e reja të vendbanimeve si dhe në pjesët ku ai nuk ekziston;
 - Rindërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjithë komunën;
 - Rregullimi i shtretërve të lumenjve në të gjithë komunën me qëllim të parandalimit të vërshimit të lumenjve;
 - Krijimi i korridoreve të gjelbra përgjatë shtretërve të lumenjve dhe rrugëve aty ku është e mundur;
 - Ndërtimi i sistemeve të ujërave të zeza në fund të lumenjve - kolektorë të ujërave të zeza;
 - Ndërtimi i depozitës së sedimentimit në Graçanicë;
 - Ndërtimi i stacionit të zjarrfikësve;
 - Zhvillimi i transportit publik që lidh të gjitha vendbanimet;
 - Në Graçanicë dhe në të gjitha vendbanimet e tjera janë planifikuar stacione të autobusëve;
 - Rregullimi i parqeve ekzistuese për fëmijë dhe krijimi i të rejave;
 - Mirëmbajtja dhe rregullimi i të gjitha varrezave në territorin e Komunës

23. Analiza Mjedisore E Skenarëve Të Propozuar Alternativë

23.1 Skenari i Mos-Bërjes Asgjë

Sipas skenarit të të mos-bërit asgjë i cili do të rezultonte nëse nuk do të zhvilloheshin kurrfarë aktivitete zhvillimore të planifikuara në mënyrë strategjike, zona e PZHKG, do t'i mbante karakteristikat e saj aktuale fizike, mjedisore dhe shoqëro-ekonomike. Zhvillimi do të shënohej brenda kufijve dhe parametrave ekzistuese të zhvillimit. Investimi i ardhshëm nga Komuna e Graqanicës dhe të tjerët do të mungonte aty ku nuk parashikohet me plan zhvillimor dhe roli i komunës si ndikim proaktiv në vend do të humbte. Zbatimi i skenarit të të mos-bërit asgjë do të nënkuptonte që Graqanica do të mbetej pak i shfrytëzuar me përmirësim të vogël fizik, shoqëror ose ekonomik.

Tendenca urbanistike do të mund të vazhdonte e pakontrolluar me rezultat të mundshëm të shtrirjes urbane e cila është e lidhur me shtrirjen e paplanifikuar të zhvillimit në vendet jashtë dhe brenda qytetit të Graqanicës.

Bërthama e qytetit mund të humbë me rritjen e re të paplanifikuar jashtë mase. Ky model i zhvillimit shpesh rezulton me rritje më të madhe se që pritet dhe në një shkallë më të shpejtë se që pritet me vështirësi në lidhje me kërkesat problematike shoqërore, të transportit dhe të infrastrukturës së gypave për ta planifikuar hapin e mundshëm të zhvillimit. Në anën tjetër, gjendja shoqëro-ekonomike dhe mjedisore në viset rurale do të mund të përkeqësohej në mënyrë të konsiderueshme nëse ofrimi i shërbimeve publike dhe i mundësive për punë ulet dhe projektet e propozuara të udhëhequra nga qëndrueshmëria nuk do të zbatohen.

Meqë në thelb PZHKP 2022 - 2031 është menduar për t'i zgjedhur çështjet aktuale mjedisore dhe për ta përkrahur zhvillimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm dhe përfshin vetëm disa propozime për projekte të cilat mund të përfshijnë (nëse nuk planifikohen, përgatiten dhe zbatohen në mënyrë të arsyeshme) disa ndikime negative në mjedis, skenari i të mos-bërit asgjë do të mund të konsiderohej si ai i parapëlqyeri.

23.2 Skenari Me Qasje Policentrike

Zbatimi i plotë i skenarit të PZHKG 2022 - 2031, Ky skenar do të thotë që do të zbatohet koncepti i zhvillimit hapësinor i qasjes policentrike, në nën-qendra do të sigurohet një nivel shtesë i shërbimeve publike me shpresën e ruajtjes së rritjes dhe të zhvillimit të lagjeve rurale. Një rajon hierarkik policentrik përmban disa qendra urbane të cilat janë të organizuara në strukturë hierarkike të vendit kryesor. Në këtë strukturë urbane, një qendër (qyteti i Graqanicës) dominon mbi të tjerat. Kjo qasje aktualisht është shumë e përhapur dhe është në pajtim me Perspektivën Evropiane të Zhvillimit Hapësinor .

Ajo duhet të ndihmojë në gjetjen e baraspeshës ndërmjet viseve rurale dhe urbane dhe të ofrojë kushte që viset rurale t'i asimilojnë ndryshimet strukturore në mënyrë më të suksesshme. Pasi që në Graqanicë tendenca e rritjes së popullsisë tregon që qyteti i Graqanicës priret të bëhet më i madh dhe të zgjerohet drejt periferive. Nëse nuk menaxhohet si duhet kjo rritje do të përbëjë kërcënim për zonat

me vlera të pasura ekologjike ndërmjet qendrës së qytetit dhe vendbanimeve periferike. Për ta zvogëluar atë kërcënim dhe në mënyrë që të ketë për qëllim zhvillimin e ekuilibruar hapësinor PZHKP

2022 - 2031 propozon Konceptin e Zhvillimit policentrik.

Nëse zbatohet si duhet, nuk mund të parashikohet kurrfarë ndikimi domethënës negativ si rezultat i zgjedhjes së konceptit hapësinor. PZHKG, po ashtu shfrytëzon mjetin e Procesit Analitik të Hierarkisë (PAH) për t'i treguar zonat e përshtatshme për zhvillim të ardhshëm (siç është banimi, industria, turizmi, bujqësia, etj).

Si rrjedhojë e kësaj janë përgatitur hartat PAH ku mund të gjenden hapësirat e përshtatshme për zhvillimet e ardhshme. Pasi që karakteristikat sipas të cilave shënohet hapësirat e përshtatshme mund të vlerësohen në përgjithësi në mënyrë të përshtatshme, zbatimi i mëtejshëm i rezultatit të analizës duhet të ketë ndikime pozitive mjedisore. Ato sugjerojnë që aktivitetet me mundësi ndotëse (të banimit, industriale, bujqësore) përjashtohen në hapësirat e cënueshme në aspektin e mjedisit. Por PZHKP 2022 - 2031 nuk i integron rezultatet PAH me qasjen e zhvillimit policentrik për të ofruar strukturë koherente hapësinore/ndarje . Si rezultat, do të ishte sfiduese që të zbatohet mënyra e qëndrueshme dhe e bazuar në analizë për zhvillimin e mëtejshëm të planifikimit

hapësinor në komunën e Graçanices . Prandaj, nëse as koncepti i zhvillimit policentrik as rezultatet PAH nuk zbatohen në mënyrë efikase, mund të përfundojë me zhvillimin e vazhdueshëm të rastësishëm të hapësirave të vendbanimeve/industriale dhe me ndikime negative në mjedis.

Do të zhvillohet i gjithë procesi i zbatimit prej të cilit dalin kryesisht ndikimet mjedisore pozitive. Edhe pse, meqë ekziston një shkallë e gjerë e projekteve përgatitore (përgatitja e planeve/programeve kryesisht të caktuara për tremujorin e parë të periudhës së PZHKG 2022- 2031) shumë ndikime të mundshme mjedisore (të cilat do të mund të vlerësoheshin po të zbatoheshin tashmë planet e propozuara) mbesin të matura dhe jo të drejtpërdrejta. Figura7. Ilustrimi i konceptit të zhvillimit hapësinor policentrik (PZHKG 2022- 2031).

23.3 Skenari Ndarjes Së Integruar

Ky skenar përmban elementin kryesor siç është koncepti policentrik hapësinor nga skenari i fundit në mënyrë që ta forcojë dhe ta balancojë raportin urban-rural në atë mënyrë që është e dobishme si për popullsinë urbane ashtu edhe për atë rurale. Por meqë zona e Graçanices është e ndikuar nga shumë faktor në zhvillim dhe nga tendenca shumë e fuqishme demografike (rritja e popullsisë), ekziston nevoja që të merret parasysh mundësia që presioni i lartë në qytetin e Graçanices do të vazhdojë dhe do të rritet dhe për këtë arsye elementet e Konceptit Kompakt të Zhvillimit kombinohen me ato policentrike. Theksohet roli i Graçanicës si qendër e fuqishme rajonale me përqendrim të objekteve urbane dhe mundësi të zgjerimit.

Zonat e zgjerimit të qytetit janë shfrytëzuar vetëm vendet e përshtatshme për analizën e zhvilluar gjatë zhvillimit të PZHKG. Në mënyrë që të ofrojë mundësi të zbatimit të kombinuara më mirë për konceptin e zhvillimit hapësinor (kombinimi i atyre policentrike dhe të kombinuara) së bashku me rezultatet e analizës, harta e nevojshme e ndarjes funksionale në zona është përgatitur si bazë për zhvillimet e mëtejshme hapësinore. Ndarja në zona duhet të propozojë vende të përshtatshme për banim, bujqësi, industri, turizëm. Meqë ky skenar alternativ zvogëlon shumë rrezikun që mund të paraqitet nëse tendenca e urbanizimit vazhdon gjallërisht dhe ofron mbështetje shitesë për zbatim (ndarja e kombinuar funksionale në zona si udhërrëfyes hapësinor për zhvillim të mëtejshëm), në këtë mënyrë identifikohet si skenar i parapëlqyer. Skenari i tretë po ashtu mbështet qasjen reale si bazë të planifikimit të zonave të reja të banimit. .Sipas asaj, skenari i tretë sugjerohet të jetë më i përshtatshmi dhe sugjerohet që harta funksionale e ndarjes në zona (e cila mbështete përmbajtjen aktuale dhe sugjerimet kryesore të PZHKG 2022 - 2031) t'i bashkëngjitet planit

zhvillimor komunal dhe zhvillimet e mëtejshme dhe planet zhvillimore do të përgatiten dhe të zbatohen në përputhje me rrethanat.

Të paraqitet përmes një harte të përbashkëte e ndare në zona sipas Skenareve 1, 2 3.

24.Masat Për Parandalimin E Dëmtimit Të Ndikimeve Të Mjedisit

Për rrjetin hipografik PZHK propozon përmirësimin e cilësisë së ujit, me heqjen graduale të mbeturinave të cilat ende ndikojnë në disa pjesë, dhe të bankave, me një program të veprimeve për secilin kanal që siguron rehabilitim të vlerave mjedisore dhe natyrore, duke forcuar aktivitete rekreative, pasurimi i biomasës buke mbjellur pemë dhe shkurre për të kompletuar skajet e peizazhit bujqësor, duke ruajtur elementet e mbetura historike të peizazhit. Matje të shumta kushtuar mbrojtjes së mjedisit (ruajtja e peizazhit, mbeturinat solide dhe përpunimin ujërave të humbura, politikat pylltarisë...) janë përmendur në paragrafët e mëhershme. Sidoqoftë, është e mundshme të radhiten matjet e veçanta të mëposhtme:

24.1 Reduktimi i ndotjes akustike

Për të reduktuar ndotjen akustike në zonat urbane duhet të ndiqen veprimet e duhura, dhe përmes ndërhyrjeve kushtuar pajisjeve dhe performancës së infrastrukturës, edhe nga ndërhyrjet direkte në burimet e zhurmës.

Për vendbanimet e reja, vlerësimi i ekspozimit të ndotjes akustike do të ndihmojë në çasje inovative në dizajn dhe konstruksion. Matjet për zbutjen e zhurmës, ku është e nevojshme, duhet të integrohen me mjedisin dhe të kontribuojnë në cilësinë e hapësirave urbane. ***Reduktimi i ndotjes së ajrit***

Për reduktimin e ndotjes së ajrit në ambientin urban, duhet të ndiqen veprat e duhura. Ndërhyrjet në vendbanimet e reja duhet të sigurojnë rritje të biomasës në zonat e gjelbërta, dhe të jenë në gjendje të absorbojnë ndotjen duke zvogëluar kështu përqendrimet.

24.2 Mbledhja dhe hedhja e ujit

PZHK duhet të marrë në konsiderim ndërtimin e sistemit të dyfishtë për ndërtesat e reja.

Në veçanti, në zonat e zhvillimit të ri, lehësimi dhe rehabilitimi, duhet të jenë të ndarë në disa sisteme për mbledhjen e ujërave të zeza të kushteve atmosferike , me qëllim që të ripërdorohen në

përputhshmëri, edhe jashtë zonave në të cilat gjenden.

Ruajtja e ujit, për të reduktuar konsumimin e ujit të pijshëm, shiu do të mblidhet dhe do të përdoret si ujë përuritje. Reduktim i mëtutjeshëm mund të arrihet duke përdorur instalime sanitare që rrjedhin ngadalë, duke ripërdorur ujërat e hirta aty ku duhet dhe implementuar sisteme gjeotermale në vend të kullave tradicionale ftohëse, të cilat përdorin një sasi të madhe të ujit të pijshëm. Sipërfaqet tokësore dhe kulmore duhet të jenë të dizajnuara të depërtueshme për menaxhim efikas të ujërave atmosferike.

24.3 Ruajtja e Energjisë

PZhK propozon hartimin e një Plani për të përcaktuar ndërhyrjet për reduktimin e humbjes së nxehtësisë në ndërtesat ekzistuese dhe për të caktuar standardet e cilësisë për ndërtesat e reja, në linjë me udhëzimet Evropiane.

Efikasiteti duhet të arrihet nëpërmjet strategjive të zgjuara dhe të thjeshta që nuk kanë nevojë për teknologji komplet të reja. Kërkesat e energjisë do të minimizohen nëpërmjet zbatimit të strategjive pasive që aty ku është e mundur të arrihen kërkesat e mbetura nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave të integruara. Aty ku është e mundur do të bëhet furnizimi me energji nga burimet e ripërtëritshme.

Strategjitë pasive përfshijnë:

- Fasada të izoluara me dritare
- Rregullimi i ndërtesave për verë dhe dimër me ngrohje dhe freskim për secilën stinë
- Shfrytëzim maksimal i dritës së diellit nëpërmjet ndërtimit të elementeve që tërheqin dritën
- Zonat buferike (si kopshtet dimërore) duhet të tërheqin energjinë diellore pasive dhe të lejojnë ventilim natyral nën kushtet dimërore
- Mbrojtje nga drita diellore e jashtme

Burimet e ripërtëritshme përfshijnë:

- * Ventilim natyral për ajrin e freskët dhe/ose freskim
- * Ngruhje gjeotermale ose ftohje (opsionale)
- * Tub diellor për ngrohjen e ujit nëpër shtëpi
- * Fotovoltaics

Teknologjia LED mund të përdoret si sistemi primar i ndriçimit në ndërtimin e interierëve. Kjo teknologji i redukton kërkesat për mirëmbajtje gjatë një jetëgjatësie më të madhe dhe reduktim të kostos nëpërmjet kostove më të ulëta të ndërtimit.

24.3.1 Masat për parandalimin ndikimin negative social

Planifikimi dhe dizajni i të gjitha zonave do të sigurojë një mjedis që mund të mirëpresë një shoqëri të hapur me një diversitet të banorëve, njerëzve që banojnë aty, vizitorëve të qytetit. Njerëzit do të takojnë fqinjët e tyre dhe do të ndjejnë se i përkasin këtij komuniteti.

- * Sigurimi i tipologjive të ndryshme të banimit
- * Mbështetja e identiteteve të lagjeve të ndryshme
- * Një rrjet publik hapësirë ku banorët duan të takohen me fqinjët dhe për të gjetur mundësi për të komunikuar

Programimi i hapësirave në natyrë do të sigurojë :

- * Objektet për të luajtur
- * Ulëse publike
- * Fushat për evenimentet në natyrë dhe tubime të mëdha
- * Zonat e sigurta, të gjelbërta dhe të qeta të lagjeve

24.4 Dispozitat në lidhje me bashkëpunimin

Për të koordinuar zbatimin e PZhK-së komuna mund të promovojë arritjen e marrëveshjeve territorial me komunat e tjera dhe me qeverinë, për shkak të integritit të ngushtë dhe ndërvarur të marrëveshjeve mbi vendbanimet dhe homogjenitetin e karakteristikave të natyrës, mjedisit dhe peizazhit të komunave.

Përmirësimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe ndërgjegjësimit Zbatimi dhe përforsimi I planeve zhvillimore dhe rregulluese do të jetë i suksesshëm vetëm kur komuna të mund të krijojë ndjenjën e mbështetjes dhe besimit mes banorëve të saj. Një kampanjë mediale do të organizohet për të forcuar ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe të rrisin mbështetjen e tyre për planifikimin e aktiviteteve.

Centralizimi i informacionit hapësinor Informacioni hapësinor i mundshëm do të qendërohet dhe integrohet në një sistem GIS që do të jetë i qasshëm të paktën nga të gjitha drejtoritë e administratës komunale.

Lejet e ndërtimit Procesi I dhënies ose refuzimit të lejeve të ndërtimit, duke përfshirë garancion për rolet transparente të të gjitha palëve të interesuara (aplikantë, rezidentë, palë të tjera dhe administrate) do të përmirësohen me marrëveshje të qarta.

24.4.1 Dispozitat mbi rendin kronologjik ose fazat e zbatimit

Plani investitor komunal duhet të bëhet sipas veprimeve që kanë rezultuar si më të rëndësishme dhe urgjente sipas PZhK..

Në një kohë të shkurtër pas aprovimit final të PZhK, asambleja komunale duhet të aprovojë një plan buxhetor shtesë në të cilin shprehet qartë se si do të financohet zbatimi i këtyre dy planeve për tre vitet e para. Ky plan buxhetor shtesë duhet të përcaktojë përveç te tjerave edhe hartimin e PZHK, duke zbatuar inventarin dhe hartimin e studimeve shtesë të fizibilitetit, planeve sektoriale dhe instrumenteve të tjera që duhet të financohen.

Pas aprovimit përfundimtar të PZHK-së, Komuna duhet të rishikojë politikat e sektorit ekzistues për ti pasur të harmonizuara me komisionin e PZHK-së

24.4.2 Elementet dhe udhëzimet për hulumtime të mëtutjeshme

Studime dhe kërkime për identifikimin në kohë të zonave që duhet të mbrohen në lidhje me mbrojtjen e sipërfaqeve dhe burimeve me ujë nëntokësor, dhe gjendjen hidrologjike. Duhet identifikuar zonat në rrezik përmytjeje.

Definicioni i këtyre pjesëve të kodrës/malit për tu ruajtur, për të parandaluar format e përdorimit të tokës që mund të shkaktojnë shqetësim publik në formën e shpyllëzimit, humbjes së stabilitetit ose përkeqësimi i sistemit ujour.

Do të identifikohen si zona të ndikuara nga mungesa e stabilitetit dhe fenomeni erozionit (psh rrëshqitjet e tokës ose faza e rregullimit, duke rezultuar në kushtet morfologjike dhe klimatike: një fenomen që ndodh për shkak të kushteve morfologjike dhe klimatike shumë të ngjashme me të tashmen, në dukje stabile por që e kanë ezauruar zhvillimin e tyre dhe mund të riaktivizohen).

25. Gjelbërimi

Së bashku me gjelbërimin, duhet të jetë një zbukurim në përputhje me të gjitha kategoritë e rrugëve. Rrugët lokale dhe të qarkut në veçanti mund të zbukurohen me orë, me Fontana dekorative me ujë të pijshëm, si dhe ulëse për pushim . Zbukurimi duhet të përfshijë ndalesat e autobusëve, kabinat publike të telefonit, ulëset, shportat e bërllokut për këmbësorë, parkingje për biçikleta si dhe elemente tjera që prezantojnë kulture qytetare, Kjo është veçanërisht e rëndësishme për qytete sikur

Graqanices ku turizmi është prioritet, dhe rruga është elementi i parë ku turisti vjen në kontakt me qytetin, çështjet e mëposhtme kritike mund të zbulohen:

Zhvillimet e paplanifikuara me mungesën konsekuente të pajisjeve, hapësirave të gjelbra publike, Aksesit i dobët nga vendbanimet periferike.

Situatat e mundshme të rrezikut (p.sh. paqëndrueshmëria gjeologjike apo afërsia me industrinë e rrezikshme).

Zgjerimet me densitet të ulët konsumojnë dhe copëtojnë kualitetin e tokës bujqësore më shumë se që është e arsyeshme me të njëjtën popullsi të caktuar. Ata gjithashtu kërkojnë një rritje në përdorimin e automobilitave dhe të bëjnë të përealizueshme një mjedis urban të pasur, pajisjeve dhe aktivitetet ekonomike.

Në mënyrë që të sigurohet për qytetarët një ofertë e një qyteti cilësor, ne duhet të lidhim rritjen e popullsisë me ofrimin e pajisjeve të përshtatshme dhe të infrastrukturës. Situata aktuale të strehimit në të ardhmen e afërt do të gjenerojë një kërkesë të përhapur për përmirësimin e cilësisë së fondit ekzistues banesor; për më tepër pjesa tjetër e kërkesës për strehim të ri do të gjenerohet nga rritja e numrit të familjeve, të lidhura me zvogëlimin e numrit të anëtarëve të çdo familje dhe në karakter të ri të popullsisë. Roli i vërtetë i kryeqytetit, pa politikën adekuate, bëhet një tjetër faktor tërheqës i popullsisë urbane, që ndikojnë në migrimin e brendshëm të kryeqytetit. Shtrirja e proceseve të fundit në një anë anon në boshtin qendror historik të lidhur me rrugët dhe hekurudhat, por nga ana tjetër kanë tendencë për të pushtuar mjedisin rrethues përderisa zonat e pyllëzuara dhe të vlefshme rrethojnë qytetin. Ekziston rreziku i humbjes së perceptimit të formës origjinale urbane dhe të marrëdhënieve të tij me mjedisin natyror përreth qytetit; një tjetër rrezik është dhe rritja e dendësisë së zonave qendrore, me pasoja të ndotjes së mjedisit. Ekziston rreziku i zhvillimit të periferive të zgjeruara, ku është e vështirë për të siguruar komoditet dhe cilësi jetësore.

Për të adresuar këto çështje ne propozojmë një strategji të bazuar në shtrirje të plotësishtme të kualitetit urban "bazë" në aspektin e komoditetit dhe hapësirave publike; përshtatja me standardet evropiane të rrugëve, me ndërtimin e shtigjeve të këmbësorëve, Çiklisteve dhe parkingjeve të automjeteve, rritjen e rrjeteve teknologjike; rritja selektive e vendbanimeve, të vendosura në mënyrë për të rritur dhe ruajtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore dhe gjithmonë duke u mbështetur nga zhvillimi i infrastrukturës, komoditetit dhe hapësirave publike, mobilitetit të qëndrueshëm, rrjetet teknologjike. Në mënyrë për të vlerësuar rritjen e mundshme të vendbanimeve kufiri i sipërm i qëndrueshmërisë së popullsisë i krahasuar me nivelin e komoditetit dhe infrastrukturës në gjendje për të siguruar një nivel të mirë të cilësisë jetësore urbane, do të identifikohen:

- **zonat e konsoliduar urbane**, ku ndërtesat e reja janë të ndaluara, me përjashtim të vetëm për zëvendësimin e stoqeve ekzistuese; në këto fusha objektet publike, hapësira (dmth sheshet) duhet te forcohen si psh parqet, pajisjet adekuate, rrjetet rrugore duhet të krijohen si për këmbësorë njashtu dhe shtigjet e çiklisteve dhe parkingje për makina.
- **kompletimi dhe kompresimi i zonave urbane** (përmes hapësirës që gjinden ne mes dy ndërtimeve ose rindërtim ndërhyrje). Duke marrë parasysh dendësinë e ulet prezentë, ne propozojmë lehtësimin e proceseve te densitetit, bazuar në një rritje prej 20 banesave / ha.
- **përzgjedhja e zanave te zgjeruar**, me krijimin e strukturës së re urbanistike, me dendësitet prej 50 banesave / ha (të përshtatshme për të mbështetur zhvillimin e transportit publik, komoditetit dhe bizneset në zonë urbane).

Kudo që të jetë e mundur, hapësirat e gjelbra duhet të rriten si për përmirësimin e cilësisë se mjedisit dhe për të rritur biodiversitetit. Për më tepër, lëvizja e qëndrueshëm duhet të jetë pjesë e një qasjeje të integruar. Reduktimi I ngjeshur është i rëndësishëm nëse e shikojmë nga pikëveshtrimi i shendetesise, por kjo nuk është vetëm në lidhje me reduktimin e emisioneve të CO2, ndotjes dhe zhurmës – ka lidhje gjithashtu për dhënie te mundësisë se qytetareve për ri- pushtim te qytetit. Rrugët me trafik të rëndë janë pengesa efektive që kalojnë nëpër qytete, ku izolojnë lagjet dhe i bëjnë te duken joatraktive. Objektet publike, së bashku me hapësirat komerciale dhe pasuritë e tjera të strukturave urbane, duhet të vendosen në një formë të përmbledhur në mënyrë që të ndërtojnë vende të gjalla dhe tërheqëse dhe gjallë të arritshme në këmbë ose me biçikletë.

Ne duhet të inkurajomë krijimin e modelit të përzier urbane, ku funksionon e banimit bashkëjetojnë me bizneset e vogla, zejtarisë, zyrat, që synon t'u japë vitalitet hapësirës urbane në kohë të ndryshme të ditës, për të reduktuar lëvizjet (parimi i afërsisë) dhe për të rritur sigurinë urbane. Standardi minimal i propozuar për lehtësitë dhe pajisjet themelore është 18 banor m2/për banues teorik. ("standard" do të thotë një raport minimal në mes të hapësirave të banimit dhe hapësirave për aktivitete sociale, hapësirave të gjelbra dhe parkingjeve publike).

26. Krijimi dhe sigurimi i hapësirave publike me cilësi të lartë

Sasia dhe cilësia e hapësirave publike luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kushteve të jetesës së popullsisë urbane. Si një faktor vendor, cilësia e hapësirës urbane është e rëndësishme për të tërhequr investimin industrial, burime njerëzore të afta dhe kreative, dhe për të rritur turizmin.

Cilësia dhe estetika e ambientit të ndërtuar dhe hapësirave publike janë faktorë të rëndësishëm për

atraktivitetin e një qyteti. Hapësira publike tërheqëse që funksionojnë mirë dhe një mjedis në përgjithësi estetik mund të jenë simbole të një qyteti dhe të të jetuarit së bashku. Kjo i jep popullit ndjenjën e pronësisë së këtij qyteti. Idealja do të ishte që hapësirat publike të jenë shumë funksionale, miqësore për më të moshuarit dhe të mund të akomodojnë fëmijët, si dhe të jenë vend takimi dhe po ashtu ti shërbejnë funksioneve specifike.

Të bëjmë lëvizshmërinë e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të shëndetshme, një qytet që arrihet dhe udhëtohet lehtësisht

Zhvillimi i lëvizshmërisë së qëndrueshme është një sfidë kyçe për qytetet e së nesërme. Mobiliteti qëndrueshëm përfshin dimensione dhe përbërës të ndryshëm: sistem transporti i qëndrueshëm, efikas në harxhimin e energjisë dhe i përballueshëm; një ambient miqësor për mënyrat e transportit me biçikletë dhe në këmbë; qasje e lehtë në të gjitha lagjet në këmbë, biçikletë apo transport publik; rrjete urbane që duhen planifikuar në kontekstin e përdorimit gjithëpërfshirës të tokës dhe zhvillimit hapësinor; dhe nyje transporti që duhet të integrohen mirë me aktivitetet sociale, kulturore, dhe ekonomike duke përfshirë argëtimin. Infrastruktura e lëvizshmërisë duhet të zhvillohet me një perspektive afatgjatë në të cilën merren parasysh nevojat për të ardhmen, zhvillimet urbane, hapësinore dhe teknologjike.

26.1 Një balance mes natyrës dhe traditës

Për aq sa është e mundur, territori i komunës së PZHK duhet të zhvillohet në një mënyrë të balancuar. Një balancë e zhvillimit me natyrën thekson se ka një nivel të intensitetit të banimit ku burimet që konsumohen do të zëvendësohet nëpërmjet cikleve natyrore të stinëve, duke krijuar kështu një ekuilibër mjedisor. Një balancë mes zhvillimit e natyrës ka si qëllim përdorimin racional të burimeve natyrore dhe një balancë më e mirë mes zhvillimit social, ekonomik, dhe mjedisor. Balanca me traditën ka si qëllim të integrojë ndërhyrjet e planifikuara me asetet kulturore ekzistuese, duke respektuar praktikatat tradicionale. Ky princip i planifikimit urban kërkon respekt për trashëgiminë kulturore të vendit. Planet hapësinore, planet rregulluese dhe planet e menaxhimit përmbajnë masa gjithëpërfshirëse për të mbrojtur vlerat natyrore dhe kulturore, si dhe integritetin historik.

KAPITULLI VIII

27. Prioritetet Zhvillimore Strategjike Te PZHK-së Dhe Fushat Perkatese

Qëllimet dhe objektivat e përcaktuara janë prioritetizuar sipas rëndësisë me qëllim të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal si dhe alokimit të kapaciteteve financiare dhe njerëzore.

Prioritetet Kryesore të Zhvillimit Strategjik te PZHK-se	Fusha tematike përkatëse
Përkrahja e bujqësisë dhe blegtorisë	Ekonomia Transporti Infrastruktura teknike Mjedisi
Përkrahja e zhvillimit ekonomik sipas potencialeve lokale dhe kërkesave ne nivel kombëtar dhe regjional	Ekonomia Transporti Infrastruktura teknike
Zhvillimi i qëndrueshëm hapësinor i vendbanimeve	Vendbanimet dhe banimi Ekonomia Shërbimet sociale Infrastruktura sociale&publike Transporti Infrastruktura teknike Mjedisi
Furnizimi cilësor me ujë dhe menaxhimi i ujërave të zeza	Infrastruktura teknike Vendbanimet dhe banimi Mjedisi
Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i mbeturinave	Mjedisi Vendbanimet dhe banimi Ekonomia Shërbimet publike Infrastruktura teknike Transporti
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore e natyrore, dhe promovimi i kapaciteteve turistike	Mjedisi Trashëgimia Ekonomia Infrastruktura teknike

Tabela 9. Prioritetet zhvillimore strategjike te pzhk-se dhe fushat perkatese

Prioritetet tjera të zhvillimit strategjik	Fusha tematike përkatëse
Edukimi cilësor dhe gjithëpërfshirës	Arsimi Infrastruktura sociale Ekonomia
Shërbime shëndetësore cilësore	Shëndetësia Infrastruktura sociale
Sigurimi i banimit të qëndrueshëm	Vendbanimet dhe banimi Ekonomia Shërbimet sociale Infrastruktura sociale&publike Infrastruktura teknike
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit publik, si dhe menaxhimi qarkullimit	Transporti Infrastruktura teknike Vendbanimet dhe banimi Ekonomia
	Mjedisi
Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike (kapacitetet, burimet alternative)	Infrastruktura teknike Vendbanimet dhe banimi Ekonomia Mjedisi
Shqyrtimi i mundësive për eksplotimin e potencialeve minerale	Ekonomia Transporti Infrastruktura teknike Mjedisi
Përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të infrastrukturës sociale (kulturë, sport, rekreacion)	Kultura Sporti dhe rekreacioni Infrastruktura publike
28. Sfidat kryesore të identifikuara janë:	
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave ✓ Trajtimi i ujërave të zeza ✓ Mbrojtja e pyjeve dhe tokës bujqësore ✓ Mbrojtja nga fatkeqësitë ✓ Largimi i deponive joformale dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes ✓ Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave dhe riciklimi i tyre ✓ Trajtimi i ujërave të para shkarkimit në rrjedha natyrore ujore ✓ Menaxhimi/monitorimi i zhvillimit hapësinor të vendbanimeve dhe ndalimi i ndërtimit në toka bujqësore ✓ Monitorimi i përdorimit të plehrave kimike në toka bujqësore ✓ Ndalimi i prerjeve ilegale dhe degradimit të pyjeve ✓ Parandalimi i pasojave ✓ Pastrimi dhe rregullimi i brezave dhe shtretërve të lumenjve me qëllim të sigurimit të rrjedhjes dhe shmangies së vërshimeve ✓ Ngritja e sistemit/kapaciteteve paralajmëruese, mbrojtëse dhe menaxhuese në rast të fatkeqësive 	

Tabela 10. Prioritetet tjera zhvillimore strategjike te pzhk-se dhe fushat perkatese dhe sfidat


28.PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PLANI I VEPRIMIT

28.1 PRIORITETET STRATEGJIKE

Ekipi i Planifikimit Komunal në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive komunale, zyrtarët komunalë, përfaqësuesit e fshatrave me qëllim të punës transparente dhe përfshirjes së qytetarëve në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, kanë përgatitur anketën “Objektivat për Zhvillimin e Graçanicës” me objektivat e mësipërme. Anketa është publikuar në ueb faqen e komunës, si dhe në grupin komunal në Facebook. Krahas qytetarëve, mundësinë për të renditur prioritetet e kanë shfrytëzuar edhe punonjës të Komunës së Graçanicës, përfaqësues të sektorit civil, përfaqësues të biznesmenëve të zonave afariste dhe të tjerë.


Renditja është bërë sipas fushave tematike nga prioriteti më i lartë në të mesëm dhe më të ulët. Rezultatet e këtij sondazhi janë paraqitur në mënyrë të detajuar në grafikët e mëposhtëm.

Infrastruktura Sociale, Banimi dhe Demografia (A)




Grafiku 1. Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia

Zhvillimi Ekonomik (B)




Grafiku 2. Zhvillimi Ekonomik

Infrastruktura, Shërbimet Publike dhe Transporti (C)



Grafiku 3. Shërbimet Publike, Infrastruktura dhe Transporti

Mjedisi, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore (D)



Grafiku 4. Mjedisi, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore

KAPITULLI IX

29. Analiza E Plotë E Ndikimit Në Mjedis Të PZHK-së Sipas VSM-së

Ndikimi i problemeve mjedisore nuk është përkthyer ende në efekte ekonomike apo shëndetësore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë plani mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, të cilat janë edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan. Tabela e mëposhtme shërben si një check-list e kriterëve mjedisore sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij plani. Kjo listë tregon nëse PZHK-së e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon nepermjet shenjave si mëposhte:

Atje ku PZHK-ja , jep përgjigje të plotë problemit është vendosur treguesi √;

Nëse PZHK-ja e ka trajtuar problemin, por ka nevojë për masa të mëtejshme vendoset treguesi ?;

Nëse ka problem i cili duhet të trajtohet nga PZHK-ja, vendoset treguesi X.

Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në PZHK?	Si është trajtuar problemi në PZHK?	Treguesi
Përfshirja e konsideratave mjedisore	Po	Përfshihen në seksionet e mëposhtme.	√
Problemet e evolucionit demografik	Po	Njeh faktin se kjo është ende e vështirë për tu parashikuar saktë, pasi të dhënat kundërshtojnë njëra-tjetrën. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë fleksibilitet ,për ti lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme.	√
Skenarët e evolucionit demografik	Po	Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet. Mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore.	√
Planifikimi Urban dhe Drejtimi i Zhvillimit	Po	Njeh nevojën për pranimin e zhvillimit aktual,përveç zonave ku mund të shkaktohen probleme mjedisore	√
Kapacitetet	Po	Vlerësohet se Graçanica ka një gjurmë të lartë të	

mjedisore në zonat e propozuara për zhvillim		cenimit ekologjik, duke e tejkaluar kapacitetin e saj mjedisor. Zonat e mëdha të propozuara për zhvillim urban apo ekonomik kanë qenë më parë të kategorisë “tokë bujqësore” të konvertuara me vonë në zona informale, siç është rasti i shtrirjes së Graçanices drejt Veriut -Jug , Perendim -lindje.	√
Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të reja të çlodhëse	Po	Ka shumë probleme të mungesës së tokës dhe propozon mbrojtjen e tokës bujqësore dhe rritjen e hapësirave gjelbruese rreth qytetit duke krijuar një Kurorë të gjelbër të përbërë nga disa sisteme kodrinore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta elemente, përfshirë dhe lumenjtë, të kenë kufijt e tyre.	?
Zhvillimi i parqeve urbanë të reja brenda qytetit	Po	Një problem i mungesës së tokës brenda zonës së studimit dhe propozon një plan masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbër. Masat duhet të konkretizohen me PLVM (Planin Lokal për Veprim Mjedis), për çdo kategori zonash.	?
Rreziqet natyrore në tërësi	Po	Trajtohen në përgjithësi, por ka nevojë për vëmendje më të madhe- planifikim afatgjatë.	?
Rrëshqitjet e tokës	Po	Trajtohen në mënyrë specifike, sepse jepen standartet kufizuese për pjerrësitë e mëdha.	?
Tërmetet	Po	Në kodet e ndërtimit, por nuk gjen zbatim retrospektiv tek ndërtesat ekzistuese. Nuk ka detyrime për ndërtime me dalje emergjente në rast të rrezikut	?
Zjarret	Jo	Duhet trajtuar problemi i dendësisë së ndërtimit në mënyrë që të jenë të menaxhueshme rastet e rënies aksidentale të zjarreve në banesa.	?
Energjia & Telekomunikacioni	Po	Po	√
Energjia (efiçensa dhe energjitë e ripërtëritshme)	Jo	Mund të bënte sugjerime për projekte ndërtimi më efikase nga pikëpamja e konstruksioneve që kursejnë energjinë. Mund të sugjeronte dhe vendoste koncepte urbanistike dhe arkitektonike që promovojnë energjitë e ripërtëritshme në qytet.	X
Rrugët	Po	Ka planifikime të detajuara në lidhje me hierarkinë e rrugëve. Zonat e propozuara për përdorim të kufizuar janë shumë të vogla në plan dhe mund të zgjerohen me qëllim që të mundësojë aktivitete gjelbruese dhe të lejojë ndërtimin e rrugës atje ku	?

		ka tokë të disponueshme, pra që nuk duhet të blihet dhe ku kushtet e tokës të jenë të tilla që të reduktojnë kostot e ndërtimit..	
Qarkullimi i trafikut	Po	Synon të bëjë shpërndarjen e trafikut dhe të lehtësojë përqendrimin e tij në qendrën e qytetit.	√
Parkimi	Po	Propozim i detajuar i përfshirë në kodin e zonimit. Megjithatë njihet problemi i mungesës së vendeve të parkimit në qendrën e qytetit.	?
Siguria në rrugë	Po	Hierarkia më e mirë e rrugëve do të ulë numrin e aksidenteve. Nuk trajtohet menaxhimi i trafikut.	?
Transporti publik	Po	Duhet të ishte prioritet, por njih rëndësinë që ende kanë automjetet private. Ka nevojë për më tepër lobim dhe investime. Propozon një transport të shumëllojshëm dhe qarkullim më të sigurtë të këmbësorëve në qytet.	√
Transporti alternativ	Po	Njih nevojën për promovimin e mënyrave alternative të transportit. Veçanërisht planifikon adoptimin e një rrjeti korsi biçiletash në zonën urbane ekzistuese. Por duhet bërë më shumë në këtë drejtim. PZHK, duhet të vendosë kritere të tilla që asnjë rrugë e re e ndërtuar rishtaz apo e rikonstruktuar mos të bëhet pa pasur edhe korsinë përkatëse të biçikletave në rrugë apo në trotuar sipas rastit dhe mundësisë. Vetëm kriteret detyruese për infrastrukturën mund të krijojnë mundësinë për një rrjet korsish biçikletash në Graqanicë.	?
Cilësia e Ajrit	Po	Vetëm brenda planeve për trafikun. Nuk ka si synim të japë propozime për përmirësimin e teknikave të ndërtimit të ndërtesave apo të infrastrukturës, që do të sillnin uljen e nivelit të pluhurit. Nuk vendos kritere për mbulimin me bimësi të vazhduar të zonave të gjelbra ekzistuese apo të reja të qytetit, me qëllim për të shmangur lëshimin e PM në ajër.	?
Cilësia e Ujërave Sipërfaqësorë	Po	Lidhet me grumbullimin e trajtimin e ujërave të përdorura. Te cilat duhet te trajtohen por per shkak te kosos se larte, pzhk duhet te parashef projekt te perbashketa me komunat Fushe Kosove dhe Prishtine ne trajtimin e Ujrave te Zeza ne ITUZ qe do te ndertohe .	?
Çështje ndërkufitare	Po	Jo, nuk përbëjnë problem për momentin.	√
Konsiderata për ekologjinë dhe	Pjesërisht	Nuk përfshihen në raport, por ngadalësimi i rritjes urbane dhe mbrojtja e ujërave e pyjeve do të	?

biodiversitetin		ndihmonin në perteritjen dhe ruajtjen e biodievrstitet.	
Plani Zhvillimor	Po	Përgjithësisht po	√
Standardet Mjedisore	Po	Pjesërisht për përdorimin e tokës. Përveç përdorimit të tokës për zona të gjelbra, standardet mjedisore nuk kërkohen në plan por ndërkohë nuk ka as konflikt.	√
Standardet ndërkombëtare	Po	Të mjaftueshme për parametrat e planit dhe nuk ka konflikt.	√
Legjislacioni mbi Mjedisin	Po	Po	√
Monitorimi dhe vlerësimi i planit të zbatimit	Po	Monitorimi mbulohet nga rregulloret e ndërtimit. Vlerësimi nuk përfshihet	?
Treguesit (paraprakë)	Po	Ofron tregues indikativë ose norma. Nuk është bërë ndonjë studim paraprak, paraqet vështirësi për tu kryer	?

Tabela 11 : Konsiderata Mjedisore e PZHK-së bazuar në VSM

Sipas vleresimit strategjik mjedisor të PZHK-se se komunes se Graqanicës PZHK-se, periudhën 2022-2031, Kjo pamje bazohet në objektivat e arritjes së statusit dhe etiketimit të një qyteti European, në linjë me parashikimet e Planit Hapësinor të Republikës se Kosovës, duke krijuar një atmosferë të favorshme për të bërë biznes, punuar, jetuar; në një mjedis të qendrueshem dhe ekologjik, ndërsa në të njëjtën kohë forcon identitetin, përmirëson lehtësirat e ndryshme (administrative, edukative, shëndetësore, sportive, rekreative dhe kulturore,etj.), duke siguruar një shpërndarje të përshtatshme, duke e bërë transportin (publik dhe privat) më efikas dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar në përgjithësi jetueshmërinë në këtë qytet dhe territor. Për të përmbushur rolin e “Qyteti moderne dhe të qendrueshem” është e nevojshme të rritet qasja dhe atraktiviteti i territorit; të shtohen marrëdhëniet nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare nëpërmjet zbatimit të rrjeteve material (infrastruktura e transportit dhe komunikimit) dhe të mirat e paprekshme (qarqet dhe rrjetet e bashkëpunimit mes qyteteve) dhe duke përmirësuar “imazhin” e qytetit të prezantuar në botën e jashtme. Graqanica ka mundësi që të implementoj objektivat e përgjithshme të PZHK-se, kuptohet me angazhimin e të gjithë akoreve apo institucionat relevante, në mënyrë që edhe të zhvillohet edhe të arrij zhvillimin qëndrueshem mjedisor, pacenenuar në mënyrë që edhe të madhe ekuilibrin mjedisor.

Masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit

Bazuar në analizën e mësipërme ky seksion bën rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me \checkmark nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë. Tabela e mesiperme përmban një përmbledhje të të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën plani u jep përgjigje secilit prej tyre. Megjithatë, një nga pikat e tabelës së mësipërme që ka të bëjë me

skenarët dhe parashikimet e rritjes së popullsisë, megjithëse është trajtuar, ka nevojë për diskutim të mëtejshëm.

DRAFT

KAPITULLI X

30. VSM – Rekomandimet sipas eksperteve mjedisor

- ✓ Veprime operationale për shtimin e hapësirave të gjelbra në Graqanicë duke e përfillë se paku minimumeve të hapësirave të gjelbërta për koke Banori 9 m²:
- ✓ Krijimi i parqeve në zonat e reja të banimit në distanca të arritshme për banorë 500-1000 m distance.
- ✓ Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura dhe të propozuara si zona të mbrojtura në komunën e Graqanices .
- ✓ Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të reja se paku për aq sa demtohet zonat e pyllit.
- ✓ Hartimi i hartave të zhurmës për zonën Urbane
- ✓ Vendosja e korridoreve të reja ekologjike sipas Planit të ri dhe zonave të Graqanices
- ✓ Nxjerrja e lumenjve të Graqanices në sipërfaqe dhe krijimi i akumulive të ujit, në zonat afër burimeve të lumenjeve.
- ✓ Të studiohen hartat e termeteve , hartat gjeologjike, bonitetit të tokës , të rreshqitjeve të tokës
- ✓ Kthimi i zonave të ndotura industriale në sipërfaqe të gjelbra;
- ✓ Gjelbërimi me drunj dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
- ✓ Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (ritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe ritje e sigurisë rrugore).
- ✓ Për çdo projekt ideor të rrugëve mbi 2 Km të bëhet VNM-ja
- ✓ Gjithashtu për projekte të mëdha të ndërtimit , Impjante të trajtimit të ujërave të zeza dhe Unaza të bëhet VNM-ja, e përcaktuar sipas ligjit të VNM-se
- ✓ VSM gjithashtu i vendos disa kufizime zhvillimit që parashikohet nga PZHK-ja.
Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal janë;
 - a. kriteret e forta mjedisore-shëndetësore,
 - b. kriteret e trashëgimisë kulturore,
 - c. kriteret peizazhike dhe
 - d. kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.
- ✓ Monitorim i zbatimit të PZHK-së dhe parametrevë mjedisore të tij do jetë qels i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e

mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

- ✓ Së fundmi – por jo nga rëndësia – duhet të punohet vazhdimisht dha nga të gjitha institucionet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kontrollit mjedisor. Ngritja e mekanizmave të tillë në nivel komunal do duhej të ishte vetëm një hap i parë në drejtimin e duhur.

31.Monitorimi

Është kërkesë e Direktivës SEA (Strategic Environment Assesment), për të hartuar efektet e rëndësishme të PZHK-së. Nuk është e nevojshme të monitorohen të gjitha ose të monitorohet një efekt në kohë të pacaktuar. Monitorimi nevojitet të fokusohet në efektet e rëndësishme e të qëndrueshme.

Monitorimi është i rëndësishëm për: Efektet e rëndësishme të identifikuar në vlerësimin që mund t'i jap rritje dëmtimeve të pakthyeshme ku është i përshtatshëm implementimi i masave përkatëse lehtësuese përpara se të shkaktohen dëmtimet e tilla.

Suksesi dhe zbatimi në praktikë i PZHK-së duke vlerësuar VSM-en, përkatëse do përcaktohen nga respektimi i kushteve, rregullave dhe objektivave të shpallura dhe të aprovuara. Në mënyrë të veçantë, puna do vijojë me hartimin e Planeve dhe projekteve tjera që do të detajojnë dhe qartësojnë më tej elementet kryesore të cilat paraqiten përmbledhtas në PZhK-ë. Si të tilla, duhet që këto Plane dhe projekte të ndjekin frymën dhe parimet e PZHK-së, e te mos cenojnë rregullat përkatëse. Monitorimi i respektimit të PZHK-së edhe gjatë hartimit të Planeve dhe projekteve tjera do jetë përgjegjësi dhe detyrim i komunës së Komunës së Graçanicës. Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e “Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese. E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktivës së BE për VSM-n. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet ne procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm. Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPHI-ja nëpërmjet AKMM Agjencisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal . Me qëllim që PZhK-ë të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruar edhe më sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi

i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis. Për të qene sa me racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë

përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbatuese të PZhK-së. Plani Monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit. Realizimi me sukses i kësaj ndërmarrje kërkon angazhimin e mjaftë institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjencisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit. Mbështetur në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të PZhK-së. Këtu përfshihen qoftë Planet ,projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i PZhK-së në Plane rregulluese për vendbanimet policentrite, lagje apo blloqe banimi. Komuna e ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerëzore dhe financiare të gjithë këtë veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar Drejtorin përkatës dhe struktura të tjera në vartësi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilësinë e ndërtimeve, ecurinë e pyllëzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, rregullimin e shtretërve të lumenjve, ecurinë nderimit të rrugëve të reja përfshirë ato për qarkullimin me biçikleta dhe të tjerë indikatorë që janë paraqitur në programin e monitorimit të PZHk-së. Rezultatet e monitorimit, komuna e Pejës sipas ligjit për VSM-n, duhet të publikoj në mënyre periodike çdo vit. Për elementet e tjera të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM, VNM për monitorimin dhe rezultatet të përcillen komunës së Graçanicës dhe MMPHI-s, gjegjësisht Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor të publikoj në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Temat e VSM	Treguesit e Monitorimit Mjedisor
Biodiversiteti, Bota bimore dhe shtazore	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: ➤ Habitatet dhe speciet e rrezikuara ➤ Indikatorët biologjik e ujit sipërfaqësor
Shëndeti i popullsisë dhe njeriut	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: ➤ Shkalla e papunësisë ➤ Shkalla e lindjes së ndërmarrjeve ➤ Niveli i varfërisë ➤ Kushtet e banimit ➤ Qasja nënë objekte shërbyese ➤ Cilësia e mjedisit lokal;
Toka dhe gjeologjia	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: Humbja e tokës % e zonat e erosionit
Uji	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: Lumenjtë me gjendje të mirë ekologjike ➤ Disponueshmëria e burimeve të ujit për konsumim të ujit
Ajri	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: Niveli i ndotjes së ajrit;
Faktorët klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: Emetimet e gazërave të serrave
Asetet materiale dhe energjia	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: % energjia e ripërtirshme ➤ Ndërtimet me energji të vogël
Trashëgimia kulturore, përfshirë edhe trashëgiminë arkeologjike dhe atë arkitektonike	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Tendencat (ku informatat lejojnë) vjetore janë: % peizazh i degraduar ➤ Konservimi i peizazhit bujqësor
Mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vjetor (ku informatat lejojnë) janë: % peizazhit të degraduar ➤ Ruajtja e peizazhit bujqësor

Tabela 12 – Temat e VSM-se dhe treguesit e monitorimit mjedisor

32.Përfundime

Hartimi dhe zbatimi rigoroz i PZHKG-së në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis. Ai do të orientojë rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Graqanices me qëllim dendësimin në zonat që janë të pastabilizuara ende dhe të zhvillojë zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Graqanices. Ai gjithashtu do të ruajë trashëgiminë e ndërtimit, krahas nxitjes së një peizazhi me pamje më të këndshme. PZHK-ja do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribuojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e pëlleshme bujqësore përreth. Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikase të tokës.

Ndër alternativat e paraqitura të mundshme, zhvillimi pa plan i deri tanishëm ve aspektin e problematikes së zonave ndërtimore, shoqërore dhe mjedisore të Graqanices është total I papranueshëm. Hartimi i PZHK-së është një proces i plote i planifikimit të territorit të decentralizuar për komunën e Graqanices pasi përfshin gjithë komunën dhe njëherësh integron pjesën të territoreve të komunave tjera .Ai gjithashtu shoqërohet me pjesëmarrje te gjere publike në nivelin teknik dhe strategjik, me VSM, me disa strategji e plane të më hershme, me GIS, Vlerësim të Kapaciteteve Investive, si dhe mundesine e publikut të gjere të konsultohet dhe te shprehet per projekt-Planin. PZHK-së lejon mundësinë e qartësimit dhe detajimit me te hollësishëm gjate hartimit te Planeve dhe projekteve tjera lokale (planeve rregulluese). Si e tille, alternativa e paraparë me PZHK vlerësohet e mirë dhe adekuate në kuptimin mjedisor dhe aspektet tjera . Janë pasur parasysh parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit te qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejsazhere, zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, etj. Zbatimi praktik i parimeve te përgjithshme në rastin e PZHK-së nxjerr disa përparësi si psh. Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikim përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojnë ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë historike, ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme. PZHK-ja përpiqet të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuar gjerësisht përfshi: Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë

zbatimit të PZHK-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë

që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore. Monitorim i zbatimit të PZHK-së dhe parametrave mjedisore të tij do jetë kyç i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Me hartimin dhe hyrjen në fuqi të PZHK-së arrihet një hap cilësor në planifikimin e qëndrueshëm të territorit dhe burimeve natyrore, por puna nuk përfundon këtu. Hartimi i Planeve rregulluese dhe projekteve tjera do duhet të sigurojë përfshirjen e faktorëve mjedisorë gjatë detajimit të planeve në nivel më të ulët gjatë zbatimit të PZHK-së. Përveç pikave të renditura më sipër, ka nevojë që hartimi i Planeve rregulluese të shërbejë për të përcaktuar dhe siguruar kufijtë e zonave të gjelbra, si edhe për të identifikuar dhe zhvilluar hapësira të vogla çlodhëse dhe rekreative sportive në vendbanime. Së fundmi – por jo nga rëndësia – duhet të punohet vazhdimisht dhe nga të gjitha institucionet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kontrollit mjedisor. Ngritja e mekanizmave të tilla në nivel komunal do duhej të ishte vetëm një hap i parë në drejtimin e duhur.

- Përpilimi i PZHK-se ka pasur në fokus përmirësimin e aspekteve mjedisore, dhe zbatimi rigoroz i këtyre planeve në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis, para së gjithash në terme afatgjatë.
- Ndër alternativat e paraqitura të mundshme, zhvillimi pa plan i deri tanishëm në aspektin e problematikes së zonave ndërtimore, shoqërore dhe mjedisore është total i papranueshëm
- Alternativa e paraparë me PZHK-se , vlerësohet e mirë dhe adekuate në kuptimin mjedisor dhe aspektet tjera, por duhet të merren në konsideratë kriteret e forta Mjedisore
- Janë marre parasysh parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazheve, tokës bujqësore, zhvillimin ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje,
- Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikimi përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojnë ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi

i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë historike, ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

- Përpilimi i PZHK-se se ka pasur në fokus përmirësimin e aspekteve mjedisore, dhe zbatimi rigorozi i këtyre planeve në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis, para së gjithash në terme afatgjate.
- Ndër alternativat e paraqitura të mundshme, zhvillimi pa plan i deri tanishëm në aspektin e problematikes së zonave ndërtimore, shoqërore dhe mjedisore është total i papranueshëm
- Alternativa e paraparë me PZHK vlerësohet e mirë dhe adekuate në kuptimin mjedisor dhe aspektet tjera, por duhet të merren në konsideratë Kriteret e forta Mjedisore .
- Janë marre parasysh parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazheve, tokës bujqësore, zhvillimin ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje,
- Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikimi përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojnë ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë historike, ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

33. LITERATURA

- ✓ Strategjia e mjedisit (2005-2015), <http://www.rit.edu/~wcentr/documents/data/Environ.Strategy-MEM.pdf>
- ✓ ASK Disa Fakte mbi Mjedisin 2021-2022 <https://ask.rks-gov.net/>
- ✓ Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (2011 – 2020), *Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës* (http://www.ammkrks.net/repository/docs/Strategy_and_Action_Plan_for_Biodiversity_2011-2020.pdf)
- ✓ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Kosovë (<http://www.kosovo-mining.org/kosovoweb/en/mining/tectonics.html>)
- ✓ Ndotja e lumenjve në Kosovë, raporti përfundimtar (<https://wiki.rit.edu/display/0508484012121/Final+Report,+River+Pollution+In+Kosova>)
- ✓ PLVM për komunën e Graçanicës
- ✓ Transporti i kombinuar i udhëtarëve http://en.wikipedia.org/wiki/Intermodal_passenger_transport
- ✓ Përmirësimi i qëndrueshëm në sigurinë e deponive të xeheve http://www.tailsafe.bam.de/pdf-documents/TAISAFE_Closure_and_Remediation.pdf
- ✓ Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). Strategic environmental assessment: a sourcebook and reference guide to international experience. Earthscan, USA
- ✓ Marsden, S. (2008). Strategic Environmental Assessment in International and European Law. Earthscan, USA
- ✓ https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13686/LuanNushi_CapstoneProject_Report_5-06-2011.pdf?sequence=6
- ✓ School of Business, Economics and Law. University of Gothenburg. Department of Economics Environmental Economics Unit. (2008). Kosovo Environment and Climate Analysis. [WWW document] URL: <http://www.sida.se/Global/Countries%20and%20regions/Europe%20incl.%20Central%20Asia/Kosovo/Environmental%20policy%20brief%20Kosovo.pdf>
- ✓ The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, REC. (2000). Strategic Environmental Analysis of Kosovo. REC field office in Kosovo, Pristina. [WWW document] URL: <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>
- ✓ Therivel, R.; Wilson, E.; Thompson, S.; Heaney, D. and D. Pritchard (1992) . Strategic Environmental Assessment. London, Earthscan.
- ✓ United Nations Economic Commission for Europe. (2008) Spatial Planning. Key Instrument for Development and Effective Governance. [WWW document] URL: http://www.unece.org/fileadmin/DAM/hlm/documents/Publications/spatial_planning.e.pdf
- ✓ United Nations General Assembly (2000). United Nations Millennium Declaration [WWW document] URL: <http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.pdf>
- ✓ World Bank (2012). Kosovo Country Environmental Analysis. Cost Assessment of Environmental Degradation, Institutional Review and Public Environmental Expenditure Review.
- ✓ European Parliament/Council SEA Directive, 2001. [WWW document] URL: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT>
- ✓ European Parliament/Council Habitats Directive, 1992. [WWW document] URL: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992L0043:EN:NOT>
- ✓ European Parliament/Council Water Framework Directive, 2000. [WWW document] URL:

- ✓ <http://eulex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0060:EN:> NOT
- ✓ The UNECE Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters (Aarhus Convention), 1998. [WWW document] URL: <http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>
- ✓ The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (Espoo Convention), 1991. [WWW document] URL: http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html
- ✓ UNECE Protocol on Strategic Environmental Assessment to the Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (Kiev Protocol), 2003. [WWW document] URL: http://www.unece.org/env/eia/about/sea_text.html
- ✓ http://www.kuvendikosooves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf
- ✓ Plani Zhvillimor Komunal Komuna e Graqanicës 2022-2031

DRAFT